



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJET E BASHKUARA**

**Nr. 61004-00141-00-2026 Regj. Themeltar
Nr. 00-2026-736 Vendimi (80)**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga gjyqtarët:

Sokol	SADUSHI
Iilir	PANDA
Valbon	ÇEKREZI
Ervin	PUPE
Sokol	BINAJ
Albana	BOKSI
Sandër	SIMONI
Artur	KALAJA
Arbena	AHMETI
Gentian	MEDJA
Sokol	NGRESI
Margarita	BUHALI
Enton	DHIMITRI
Enkelejda	METALIAJ
Vojsava	KOLA
Genti	SHALA

më datë 09.04.2026, morën në shqyrtim, në seancë gjyqësore, çështjen penale me nr. 61004-00141-00-2026, akti, që i përket aktit me palë:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë

PERSON NËN HETIM: Begtash Zeneli

I DYSHUAR: Për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

OBJEKTI: Vleftësimi i ligjshëm i arrestit në flagrancë dhe caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg”.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Ilir Panda dhe Genti Shala; prokurorin Arqilea Koça, i cili mbajti qëndrim në favor të nismës për ndryshimin e pjesshëm të vendimit njësuës nr. 7/2011 dhe, në lidhje me çështjen konkrete, kërkoi prishjen e vendimit 30-2025-9596 (2998), datë 17.11.2025, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, si dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues; avokatin Luan Hasneziri, i cili mbajti qëndrim në favor të nismës për ndryshimin e pjesshëm të vendimit njësuës nr. 7/2011 dhe, në lidhje me çështjen konkrete, kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; dhe pasi e biseduan çështjen në tërësi,

VËREJNË**I. Rrethanat e çështjes**

1. Më datë 16.10.2025, policia e Lezhës ka kryer një kontroll në banesën dhe ambientet përreth saj të Begtash Zenelit, pasi kishte informacione se ai merrej me shitjen e lëndëve narkotike. Gjatë kontrollit, në banesën dhe ambientet përreth në përdorim të shtetasit Begtash Zeneli është gjetur dhe sekuestruar në total 7 (shtatë) kilogram e 350 (treqind e pesëdhjetë) gram lëndë e dyshuar e llojit *cannabis sativa*. Në këto rrethana, më datë 16.10.2025, ai u arrestua në flagrancë. Prokuroria ka kërkuar në gjykatë vlerësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së arrestit në burg ndaj të dyshuarit Begtash Zenelit, për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal (në vijim KP).

2. **Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë**, me vendimin nr. 2682-539, datë 19.10.2025, ka vendosur: “1. *Vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë të personit nën hetim Begtash Zeneli, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.* 2. *Caktimin ndaj personit nën hetim Begtash Zeneli, të masës së sigurimit personal “arrest në burg” të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. (...)*”.

3. Gjykata, ndër të tjera, ka arsyetuar se referuar konkluzionit të arrirë nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr.7/2011, çmon se kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale (në vijim KPP), edhe pse i japin gjykatës diskrecion të gjerë për të vendosur, qartazi synojnë proporcionalitetin e llojit të masës së sigurimit të caktuar, me vetë nevojat e sigurimit për atë rast. Një nga arsytet e caktimit dhe zbatimit të masave të sigurimit personal është nevoja për të garantuar vijimësisht prezencën e të gjykuarit në procedimin penal në ngarkim të tij, si për të siguruar normalitetin e hetimit dhe të gjykimit në çështjen në ngarkim të tij, nevojën për të evituar rrezikun për kryerjen e veprave të tjera penale prej tij, ashtu edhe për të siguruar që ai të mos largohet, të fshihet por t’i nënshtrohet ekzekutimit (vuajtjes) së dënimit kur vendimi i dënimit të ketë marrë formë të prerë.” (Vendimi nr. 7, datë 14.10.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë). Gjykata, vlerëson se në çështjen objekt gjykimi, vepra penale për të cilën dyshohet shtetasi Begtash Zeneli ka një rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe një sanksion dënimi që shkon deri në dhjetë vite burgim. Gjykata duke pasur parasysh veprën penale për të cilën i arrestuari akuzohet, rrethanat e arrestimit, qëndrimin e të arrestuarit ndaj faktit penal, si dhe prirjen normale dhe natyrore të çdokujt për gëzimin e lirisë personale, ka vend për të dyshuar racionalisht se, personi nën hetim ka nevojë të sigurohet. Gjykata vlerëson se në rastin

objekt gjykimi, kemi të bëjmë me një frikë, mendim dhe dyshim të arsyeshëm se i hetuari po të lihet pa masë, mund të largohet për të pamundësuar apo penguar qëllimisht zhvillimin normal të procedimit penal. (...) Referuar konkluzionit të arrirë nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr.7/2011, gjykata çmon se kriteret e parashikuara nga neni 229 i KPP, edhe pse i japin gjykatës diskrecion të gjerë për të vendosur, qartazi synojnë proporcionalitetin e llojit të masës së sigurimit të caktuar, me vetë nevojat e sigurimit për atë rast. Për sa më sipër, duke marrë në konsideratë rëndësinë e faktit penal, rrethanat e kryerjes së veprës penale, sanksionin që parashikohet nga KP për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, rrezikshmërinë e autorit të dyshuar për kryerjen e saj, si edhe rrethanat lehtësuese të rastit, personalitetin e tij si i dënuar më parë, (është e kuptueshme që rrezikshmëria e autorit lidhet drejtpërdrejt me rrezikshmërinë e veprës penale), gjykata vlerëson se masa e vetme e përshtatshme e sigurimit për personin nën hetim është masa e sigurimit “arrest në burg”, e parashikuar në nenin 238 të KPP.

4. Kundër këtij vendimi, nëpërmjet mbrojtësit, **ka paraqitur ankim personi nën hetim Begtash Zeneli**, me anë të të cilit ka kërkuar ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë sa i përket masës së caktuar dhe caktimin e masës së sigurimit personal të arrestit në shtëpi.

5. **Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm**, me vendimin nr. 30-2025-9596 (2998), datë 17.11.2025, ka vendosur: *“Miratimin e vendimit nr. 2682-539, datë 19.10.2025 të Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me këtë ndryshim: Caktimin e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit Begtash Zeneli "arrest në shtëpi" parashikuar nga neni 237 i K.Pr. Penale. Urdhërohet shtetasi Begtash Zeneli të qëndrojë dhe të mos largohet nga banesa e tij në fshatin Vinjoll, Njësia Administrative Milot. (...)”*

6. Gjykata e Apelit, ndër të tjera, ka arsyetuar se në referim të analizës së mësipërme rezultoi se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që ndaj shtetasit Begtash Zeneli të caktohet një masë sigurimi personal. Për rrjedhojë, gjykata çmon të marrë në analizë llojin e masës që i përshtatet nevojave të sigurimit për rastin konkret. Në funksion të caktimit në mënyrë proporcionale dhe të përshtatshme të masës së sigurimit personal, gjykata mban parasysh kriteret e parashikuara nga neni 229 i KPP, si më poshtë: Së pari, përshtatshmërinë e masës së sigurimit me shkallën e nevojave të sigurimit në rastin konkret. Në këtë kuptim, gjykata duhet të mbajë parasysh personalitetin e autorit të veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore të tij, mundësinë e vazhdimit të kryerjes së veprave penale, rrezikun e largimit ose shmangies nga procedimi penal etj. Së dyti, ruajtjen e një raporti të drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete dhe llojin e masës së sigurimit. Së treti, rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga KP. Në çështjen objekt gjykimi rezultoi se shtetasi Begtash Zeneli dyshohet se ka kryer veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” parashikuar nga neni 283/1 i KP, e cila dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet. Gjendja gjyqësore e tij përshkruhet si i dënuar më parë por aktualisht i rehabilituar. Rezultoi gjithashtu se bashkëshortja e tij i është nënshtruar trajtimeve të vazhdueshme dhe ndërhyrjeve kirurgjikale për diagnozën “vena varikoze të theksuara” dhe ka probleme me aktivitetin ditor (raport mjekësor datë 04.11.2025, raporte epikrize datë 19.12.2023). Sa më sipër, ndryshe nga sa ka konkluduar Gjykata e Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit vlerëson se masa e sigurimit personal e përshtatshme për rastin konkret është ajo e “arrestit në shtëpi”. Gjykata e Apelit konkludon në këtë mënyrë duke mbajtur në konsideratë veprën penale të cilën personi nën hetim dyshohet se ka kryer dhe marzhin e dënimit të saj (5-10 vjet), në raport me rrethanat personale të tij e përkatësisht moshën e tij (63 vjeç), si dhe faktin se ai rezultoi të jetë kryefamiljar dhe bashkëshortja e tij ka probleme shëndetësore të cilat ndikojnë aktivitetin e saj të përditshëm. Në këto kushte, pavarësisht shkallës së lartë të përhapjes së veprës penale “Prodhimi dhe shitja e

narkotikëve” dhe prioritetit që ka drejtësia ndaj saj, nuk mund të justifikohet një trajtim i ashpër apriori, për sa kohë që çdo rast paraqitet i veçantë dhe duhet trajtuar si i tillë. Referuar arsyetimit më sipër, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, çmon se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë duhet miratuar, me ndryshimin për sa i përket llojit të masës së sigurimit të caktuar ndaj personit nën hetim Begtash Zeneli, duke caktuar ndaj tij masën e sigurimit “arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i KPP.”

7. Kundër këtij vendimi, më datë 12.12.2025, **ka paraqitur rekurs prokurori**, me anë të të cilit ka kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe miratimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë. Parashtrihen si shkaqe rekursi, në mënyrë të përmbledhur:

- Vendimi i Gjykatës së Apelit lidhur me llojin e masës së sigurimit vjen në kundërshtim me të gjitha aktet mbi të cilat është vendosur ajo masë siguri dhe janë marrë njoftimet nga gjykata, me vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 7, datë 14.10.2011.
- Nëse nuk ka shkaqe që e përjashtojnë autorin nga përgjegjësia penale, këto kritere imponojnë detyrimin e gjykatës për të bazuar vendimin, nga njëra anë, në dyshime të arsyeshme bazuar në prova mbi kryerjen e veprës penale prej tij dhe, nga ana tjetër, në prova që përmbajnë aq elemente të mjaftueshme, objektive e subjektive, mbi rrethanat e çështjes, të cilat tregojnë se ekziston gjendja e rrezikut dhe shkallën e rrezikut, së paku sipas njërës prej rasteve të nenit 228 të KPP.
- Bazuar në elementet objektive mbi natyrën dhe llojin e veprës penale, mjetet dhe mënyrën e kryerjes së saj, pasojat e shkaktuara, si dhe në elementet subjektive të lidhura me personalitetin e të gjykuarit dhe gjendjen e rrezikut, gjykata argumenton se masa e vetme e përshtatshme ndaj të gjykuarit në raport me llojin dhe shkallën e rrezikut është ajo e arrestit në burg.
- Masa e sigurimit “arrest në burg” mund të çmohet nga gjykata si e papërshtatshme, vetëm nëse ai ose mbrojtësi i tij i paraqesin gjykatës prova pozitive që tregojnë se kjo gjendje rreziku nuk është e pranishme, apo që nuk është e pranishme në atë shkallë rëndësi që të bëjë të zbatueshme masën e sigurimit “arrest në burg” (thotë vendimi unifikues).
- Nën dritën e këtij vendimi, neni 230 i KPP duhet parë i lidhur domosdoshmërisht me kërkesat e nenit 228 të KPP.
- Në këtë kontekst ndryshe nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykata e Shkallës së Parë Lezhë me të drejtë ka ardhur në përfundimin se "arrestin në burg", për të hetuarin është masa më e përshtatshme në raport me masat e tjera sepse:
- Së pari, ndaj shtetasit Begtash Zeneli ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në provat e mësipërme.
- Së dyti, veprimi që dyshohet të ketë kryer i dyshuari Begtash Zeneli, përbën veprë sipas ligjit penal në fuqi dhe nuk rezultojnë të ketë asnjë shkak padënueshmërie për këtë të dyshuar, si për sa i përket moshës së tij, ashtu edhe gjendjes mendore. Po kështu, nuk ka asnjë shkak shuarjeje në këtë rast.
- Për të dyshuarin Begtash Zeneli ekziston rreziku i ikjes, sa kohë që vepra penale që ai dyshohet është me rrezikshmëri shoqërore të lartë, pasi rezultojnë i dënueshmëri më parë, dhe e gjithë familja e tij është e përfshirë në aktivitete të kundërligjshme, ku njëri nga djemtë është i arrestuar në shtetin e Spanjës dhe djali tjetër në kërkim policor.
- Sa i përket kritereve të kërkuara nga neni 229 pika 3 të KPP, vendimmarrja e gjykatës, e cila ka gjetur si më të përshtatshme masën e sigurimit "arrest në burg" është e drejtë dhe njëkohësisht jo për ndonjë masë siguri, siç kërkoi mbrojtja, kjo pasi rrezikshmëria e personit të dyshuar rezultojnë të jetë e lartë, fakt që vërtetohet nga provat në dosje.

- Së treti, veprimet që dyshohet të ketë kryer i dyshuari Begtash Zeneli, përbëjnë vepër sipas ligjit penal në fuqi dhe nuk rezultojnë të ketë asnjë shkak padënueshmërie për këtë të arrestuar, si për sa i përket moshës së tij ashtu edhe gjendjes mendore.
- Sa i përket kritereve të kërkuara nga neni 229 të KPP, gjykata çmon si të përshtatshme masën e sigurimit personal "arrest në burg", si një masë në raport të drejtë me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet në veprën penale.
- Në caktimin e kësaj mase sigurimi është mbajtur parasysh fakti që ekziston rreziku i ikjes për të arrestuarin Begtash Zeneli, si dhe fakti në lidhje me "ekzistencën e rrezikut që personi nën hetim të kryejë krime më të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin ai po procedohet."
- Për shkak të rrethanave të faktit, duke mbajtur në konsideratë faktin se veprimet e paligjshme të kryera nga ana e shtetasit nën hetim paraqesin një rrezikshmëri të lartë shoqërore, duke patur parasysh marzhin e dënimit, si dhe faktin që janë sekuestruar sasi të konsiderueshme lëndë narkotike, 7 (shtatë) kilogram e 350 (treqind e pesëdhjetë) gramë, çka faktori se ka qenë e destinuar për tregtim të mëtejshëm, duke patur parasysh dhe personalitetin e tij, duke qenë i dënuar më parë, përsëritja e së njëjtës vepër penale apo kryerja e një veprë më të rëndë penale paraqitet si rrezik i lartë.
- Këto rrethana cilësuese të kryerjes së veprës penale, të vlerësuara në kompleksitet e të analizuar më lart, bëjnë të aplikueshme kriteret e veçanta për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg", që parashikon neni 238 i KPP.
- Nga analiza në tërësi e akteve të administruara në dosjen gjyqësore, vendimi i gjykatës së shkallës parë sa i takon llojit të masës së sigurimit është i bazuar në ligj e prova, ndaj duhet miratuar, si masa më e përshtatshme dhe që përmbush nevojat e sigurimit.
- Në caktimin e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit Begtash Zeneli, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka anashkaluar kriteret e përgjithshme (neni 229/1-2 i KPP), ashtu edhe kriteret e veçanta (neni 230/1 i KPP), pa bërë analizë konkrete të rrethanave të faktit mbi mënyrën e kryerjes së veprës penale, analizuar më lart.
- Vendimi i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është marrë në kundërshtim me praktikën gjyqësore.

8. Kryetari i Gjykatës së Lartë, me vendimin e ndërmjetëm të datës 09.03.2026, në kuadër të rolit institucional të Gjykatës së Lartë për garantimin e një praktike gjyqësore të standardizuar, të konsoliduar dhe të qëndrueshme, si dhe në mbështetje të nenit 141 të Kushtetutës, nenit 32 të ligjit nr. 98/2016 dhe nenit 438 të KPP, nisi procedurën për ndryshimin e pjesshëm të praktikës gjyqësore të unifikuar me vendimin nr. 7, datë 14.10.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në sistemin e organizimit dhe funksionimit të Gjykatës së Lartë, vënia në lëvizje e Kolegjeve të Bashkuara përbën përgjegjësi funksionale të çdo Kolegji dhe të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, sa herë që gjatë shqyrtimit të një çështjeje evidentohen arsye për të verifikuar qartësinë, qëndrueshmërinë ose përshtatshmërinë e një standardi të mëparshëm jurisprudencial. Përmes këtij mekanizmi, Kolegjet e Bashkuara thirren të vlerësojnë nëse standardi i mëparshëm kërkon qartësim, saktësim, rishikim interpretues, ndryshim ose zhvillim të mëtejshëm, në funksion të një praktike më të njëtrajtshme dhe më të harmonizuar me kuadrin aktual ligjor e konventor.

9. Në vendimin e ndërmjetëm të Kryetarit të Gjykatës së Lartë është evidentuar se *"çështja konkrete nuk paraqet interes vetëm për zgjidhjen e rastit individual, por ngre edhe nevojën për të vlerësuar nëse praktika e konsoliduar nga vendimi unifikues nr. 7, datë 14.10.2011, duhet të vijojë të mbahet në të njëjtin kuptim apo kërkon rishqyrtim të pjesshëm, si dhe nëse, krahas këtij rishqyrtimi, paraqitet nevoja për njësim ose zhvillim të mëtejshëm të praktikës gjyqësore në"*

zbatimin e neneve 228-230 të Kodit të Procedurës Penale". Kjo nevojë lidhet drejtpërdrejt me faktin se shkaqet kryesore të rekursit të prokurorit mbështeteshin në standardin e vendosur në vendimin unifikues nr. 7/2011, veçanërisht për arsytimin e llojit të masës së sigurimit, raportin ndërmjet 'arrestit në burg' dhe masave alternative, si dhe barrën e provës në vlerësimin e gjendjes së rrezikut. Nga materialet e çështjes, veçanërisht nga arsyetimi i vendimeve të gjykatave dhe nga shkaqet e rekursit të prokurorit, rezultonte se zgjidhja e rastit konkret lidhej drejtpërdrejt me disa formulime të praktikës së mëparshme unifikuese për masat e sigurimit personal, çka e bënte të nevojshëm vlerësimin nga Kolegjet e Bashkuara nëse këto formulime kërkonin qartësim, saktësim ose zhvillim të mëtejshëm. Gjithashtu në vendimin e ndërmjetëm të Kryetarit të Gjykatës së Lartë është theksuar se vendimi unifikues nr. 7/2011 ka pasur rol të rëndësishëm orientues në praktikën gjyqësore dhe se *"këto qëndrime përbëjnë një vlerë orientuese që ruajnë rëndësinë e tyre edhe sot"*, por zbatimi i tij ka ngritur nevojën për të rivlerësuar disa formulime në raport me ndryshimet e mëvonshme ligjore dhe standardet e konsoliduara të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), veçanërisht lidhur me shqyrtimin real të masave alternative, vlerësimin konkret e të individualizuar të rrezikshmërisë së veprës dhe të personit, si dhe barrën e justifikimit të nevojës për caktimin ose vijimin e masës së sigurimit "arrest në burg".

10. Në funksion të këtij objekti dhe me qëllim që shqyrtimi përpara Kolegjeve të Bashkuara të jetë i qartë dhe metodologjikisht i rregullt, Kryetari i Gjykatës së Lartë ka shtruar për zgjidhje këto çështje:

1. Në interpretim të neneve 228 dhe 230 të KPP, a është në përputhje me këto dispozita dhe me nenin 5 § 3 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) qëndrimi sipas të cilit, kur kërkohet ose vendoset masa "arrest në burg", gjykata nuk ka detyrim të analizojë realisht masat alternative dhe mjafton të arsyetojë se masa e zgjedhur prej saj është e përshtatshme për rastin konkret?

2. Në interpretim të neneve 228 dhe 230 të KPP, a mund të nxirret "rrezikshmëria e veçantë e veprës dhe e të pandehurit", si kriter për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg" vetëm ose kryesisht nga natyra e veprës penale, nga rëndësia e saj e përgjithshme ose nga marzhi i dënimit, pa një vlerësim konkret dhe të individualizuar të rrethanave të rastit dhe të personit?

3. Kujt i takon barra e justifikimit të nevojës për caktimin dhe vijimin e masës së "arrestit në burg" dhe a është në përputhje me nenin 5 § 3 të KEDNJ dhe me nenet 228-230 të KPP qëndrimi sipas të cilit papërshtatshmëria e kësaj mase mund të pranohet vetëm nëse i pandehuri paraqet prova pozitive?

II. Qëndrimi i palëve në proces në lidhje me fillimin e procedurës për ndryshim të praktikës gjyqësore

11. Prokurori mbajti qëndrimin:

11.1 Në lidhje me çështjen e parë u parashtrua: "Qëndrimi i mbajtur nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj nr. 7 të vitit 2011, të marrë në Kolegjet e Bashkuara, sipas të cilit, kur kërkohet ose vendoset masa e "arrestit në burg", gjykata nuk ka detyrim të analizojë realisht masat alternative dhe mjafton të arsyetojë se masa e zgjedhur prej saj është e përshtatshme për rastin konkret, nuk

është në përputhje me kuadrin ligjor dhe praktikën gjyqësore të detyrueshme për t'u zbatuar. Dispozitat përkatëse të KPP, nenet 228 dhe 230 në lidhje me nenin 245, si dhe dispozitat e tjera të analizuara në funksion harmonik me to, përcaktojnë qartë dhe në mënyrë taksative, se në rastin kur gjykata duhet të marrë masën e sigurimit personal "arrest në burg", vendimi i saj duhet të përmbajë, me pasojë pavlefshmërie, arsytimin e papërshtatshmërisë së masave të tjera."

11.2 Për nevoja të interesit publik, në rregullimin njësuës të parashikohet detyrimi i gjykatave të arsyetojnë se si masa alternative do të zbatohet dhe se si ajo do garantojë paraqitjen e personit në gjykim. Në rregullimin e mësipërm njësuës të propozuar, në përgjigje të pyetjes së shtruar, të shtohet dhe formulimi: "Në rastet kur gjykata, në kundërshtim me kërkesën e prokurorit, vlerëson se në rastin konkret, një masë alternative nga ajo e arrestit në burg, është e përshtatshme për të garantuar procesin, si në aspektin e nevojës së marrjes së provës dhe në aspektin e paraqitjes së autorit në procesin penal, ajo ka detyrimin të arsyetojë dhe mënyrën e zbatimit të saj sikurse dhe mënyrën se si kjo masë do të garantojë sipas rastit, marrjen e provës apo paraqitjen e autorit në procesin penal."

11.3 Në lidhje me çështjen e dytë u parashtrua se "Në interpretim të neneve 228 dhe 230 të KPP, "rrezikshmëria e veçantë e veprës dhe e të pandehurit" si kriter për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg" nuk mund të nxirret thjesht dhe vetëm nga natyra e veprës penale, nga rëndësia e saj e përgjithshme ose nga marzhi i dënimit. Rrezikshmëria e veprës penale kërkon vlerësimin dhe individualizimin e një sërë faktorësh relevantë që lidhen me faktin penal që i atribuohet personit, rrethanave në të cilën është kryer vepra, kontributin e tij në ardhjen e pasojave, pra individualizimin e situatës konkrete të kryerjes së veprës penale nga autori, ndërkohë që rrezikshmëria e personit vlerësohet nga roli i tij në kryerjen e veprës konkrete dhe nga rrethana të tjera individuale të tij që lidhen me faktorë që nuk janë të lidhur domosdoshmërisht me veprën penale por krijojnë një panoramë të qartë mbi atë se çfarë përfaqëson autori."

11.4 Në lidhje me çështjen e tretë u argumentua se "Barra e justifikimit të nevojës për caktimin e masës së sigurimit në përgjithësi dhe ajo e caktimit të masës "arrest në burg" i takon prokurorit. Papërshtatshmëria e një mase sigurimi, përfshirë këtu edhe masën e sigurimit "arrest në burg", nuk mund të varet vetëm nga sjellja ose jo e provave të konsideruara "pozitive" nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij. Ajo mund të pranohet pavarësisht nëse i pandehuri paraqet ose jo prova të tilla. Provat pozitive të të pandehurit, vlerësohen nga gjykata në harmoni me arsyet ligjore dhe faktike të paraqitura nga prokurori në kërkesën e tij."

11.5 Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete, vendimi i gjykatës së apelit nuk ka probleme që lidhen me arsytimin e vendimit në drejtim të asaj që është parashtruar në apelin e prokurorit të apelit. Çështja e vlerësimit nga gjykata e fakteve dhe rrethanave që lidhen me rrezikshmërinë e veprës dhe të autorit apo që lidhen me nevojat e sigurimit nuk hyn në sferën e gjykimit të kësaj gjykate.

11.6 Në lidhje me pretendimin se vendimi i gjykatës së apelit vjen ndesh me vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 7, të vitit 2011, konstatojmë se vendimi nuk bie ndesh me ndonjë prej formulimeve me natyrë unifikuese/njësuëse të atij vendimi edhe pse bie ndesh me një formulim me vlera orientuese. Në këtë mënyrë, formulimi i cituar nuk përbën burim të së drejtës dhe nuk mbart detyrimin për zbatim.

11.7 Në këndvështrimin e asaj që u arsyetua në lidhje me standardet e GJEDNJ, nevojës së harmonizimit të interesit publik me të drejtat themelore të individit, si dhe në harmoni me rregullimin njësuës të propozuar nga ana jonë në përgjigje të çështjes së parë, përse i përket detyrimit të gjykatës për të arsyetuar mënyrën e zbatimit të masës dhe detyrimit të arsytimit se si kjo masë, në mënyrën se si do të zbatohet, do të garantojë paraqitjen e autorit në procesin penal,

sikurse dhe në përputhje me parashikimin e bërë në nenin 237, pika 2 të KPP, rezulton se gjykata e apelit nuk e ka bërë një arsyetim të tillë. Konstatohet se vetëm në pjesën e dispozitivit ekziston një urdhërim për shtetasin Begtash Zeneli që të qëndrojë dhe të mos largohet nga banesa e tij.

11.8 I vetëm, ky urdhërim nuk përmbush as standardin e GJEDNJ dhe as pikën 2 të nenit 237 të KPP pasi, në kushtet kur nuk është arsyetuar apo urdhëruar mënyra e mbikëqyrjes së kësaj mase si edhe mënyra se si ajo do të garantonte paraqitjen e autorit në procesin penal vendimi bëhet i cenueshëm në drejtim të arsyetimit. Mungesa e këtij arsyetimi e zbeh natyrën shtrënguese të masës dhe rrezikon ta kthejë atë, në praktikë, në një masë të varur kryesisht nga vullneti i individit, për sa kohë gjykata nuk ka përcaktuar as mënyrën e mbikëqyrjes së zbatimit të saj, sikurse kërkon dispozita përkatëse e KPP.

11.9 Ndonëse vendimi i gjykatës së apelit, nuk bie ndesh me vendimin unifikues nr.7/2011 të Kolegjeve të Bashkuara të kësaj gjykate, ai rezulton i cenueshëm në drejtim të arsyetimit në lidhje me sa u argumentua më sipër dhe për këtë shkak vendimi duhet të priset dhe të kthehet për rigjykim po në gjykatën e apelit.

12. Mbrojtja mbajti qëndrimin:

12.1 Në lidhje me çështjen e parë u parashtrua: “Kur kërkohet ose vendoset masa e “arrestit në burg”, e parashikuar nga neni 238 i KPP, qëndrimi sipas të cilit gjykata nuk ka detyrim që të analizojë realisht masat alternative dhe mjafton të arsyetojë që masa e zgjedhur prej saj është e përshtatshme për rastin konkret, nuk është në përputhje me dispozitat e neneve 228 dhe 230 të KPP, si dhe as me nenin 5, paragrafi 3 i KEDNJ. Përkundrazi, kur kërkohet ose vendoset masa e “arrestit në burg”, organi procedues, prokurori dhe gjykata duhet të analizojnë realisht masat e tjera alternative të sigurimit, duke synuar që ndaj të dyshuarit të caktohet masa e sigurimit sa më pak kufizuese për lirinë dhe të drejtat e tij, në përputhje me rrezikshmërinë e veprës dhe të personit, si dhe me nevojat e masave të sigurimit në çdo rast konkret dhe caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg” mund të caktohet nga gjykata ndaj të dyshuarit, vetëm si alternativë e fundit ose “ultima ratio” kur çdo masë tjetër siguri është e papërshtatshme. “Analiza realisht” e masave të tjera të sigurimit të ndryshme nga “arrestit në burg”, nënkupton që organi procedues, prokurori mund të kërkojë dhe gjykata mund të vendosë masën e sigurimit “arrest në burg”, vetëm pasi ka argumentuar me fakte dhe prova konkrete që për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe autorit të dyshuar, sjelljes së tij para, gjatë dhe pas kryerjes së veprës penale, pasojave të veprës, përsëritjes ose vazhdimësisë së veprimtarisë kriminale, çdo masë tjetër siguri është e papërshtatshme.”

12.2 Në lidhje me çështjen e dytë u parashtrua: “Rrezikshmëria e veçantë e veprës dhe të pandehurit”, si kriter për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, në interpretim të neneve 228 dhe 230 të KPP nuk mund të nxirret vetëm ose kryesisht nga natyra e veprës penale, nga rëndësia e saj e përgjithshme ose nga marzhi i dënimit, por nga gjykata duhet të bëhet në çdo rast një vlerësim konkret dhe i individualizuar i rrethanave të ngjarjes dhe veçorive të personit të dyshuar. “Vlerësimi konkret dhe i individualizuar i rrethanave të ngjarjes dhe veçorive të personit të dyshuar”, nënkupton që gjykata para se të vendosë masën e sigurimit “arrest në burg” duhet të analizojë në mënyrë konkrete dhe individuale se kjo masë siguri është e përshtatshme, jo vetëm për shkak të natyrës veprës penale, rëndësisë së saj të përgjithshme ose marzhit të lartë të dënimit, por edhe për faktin se nisur nga rrethanat konkrete të ngjarjes, siç janë mënyra e kryerjes së veprës, qëndrimi i personit të dyshuar para, gjatë dhe pas kryerjes së veprës penale, pasojat e ardhura prej saj dhe vazhdimësia në kryerjen e veprës, si dhe për shkak të veçorive personale të të dyshuarit siç

janë moshë, gjendja e tij shëndetësore dhe familjare, sjellja e tij para kryerjes së veprës penale, e bëjnë të domosdoshme caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”.”

12.3 Në lidhje me çështjen e tretë u argumentua se “Barra e provës e justifikimit për caktimin dhe vijimin e masës së sigurimit “arrest në burg” i takon, në çdo rast prokurorisë ose organit të akuzës dhe qëndrimi sipas të cilit papërshtatshmëria e kësaj mase mund të pranohet vetëm nëse i pandehuri paraqet prova pozitive, bie në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 3 të KEDNJ, si dhe me nenet 228-230 të KPP. Po ashtu, barra e provës për të provuar përshtatshmërinë e masës së sigurimit “arrest në burg”, si në momentin e caktimit të saj për herë të parë, ashtu edhe për vijimin e zbatimit të kësaj mase pasi ajo është caktuar nga gjykata, bie në çdo rast mbi organin e akuzës dhe personin i dyshuar ose i pandehuri nuk kanë detyrimin që të sjellë prova pozitive për të provuar papërshtatshmërinë e masës së sigurimit “arrest në burg”, qoftë në momentin e caktimit të saj, qoftë edhe për vijimin e zbatimit të kësaj mase pasi ajo është caktuar nga gjykata.”

12.4 Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete, në ndryshim nga sa pretendon akuza në rekursin e paraqitur, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm ka arsyetuar mjaftueshëm se pse masa e sigurimit “arrest në burg”, nuk është e përshtatshme në rastin konkret, kjo duke u nisur nga fakti se vepra që akuzohet se ka kryer i dyshuari nuk paraqet rrezikshmëri të veçantë, pasi masa e dënimit në maksimum është deri në 7 vjet burgim, personin i dyshuar në ndryshim nga sa pretendon akuza është i rehabilituar, pra, ligjërisht i padënuar më parë, moshë e personit të dyshuar është rreth 65 vjeç, si dhe personin është në gjendje të vështirë familjare, pasi ka bashkëshorten të sëmurë rëndë që nuk mund të lëvizë nga krevati dhe ka nevojë të përhershme për shërbimin e tij, rrethana këto që tregojnë se edhe personin i dyshuar nuk paraqet rrezikshmëri të veçantë dhe se në mungesë të ekzistencës së kritereve të veçanta të parashikuara nga neni 230/1 KPP, gjykata e apelit me të drejtë ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke caktuar ndaj të dyshuarit Begtash Zeneli masën e sigurimit “arrest në shtëpi”, të parashikuar nga neni 237 i KPP.

12.5 Duke u nisur nga arsyet e dhëna në parashtrime, si dhe bazuar në qëndrimet e mbajtura nga mbrojtja për secilën nga pyetjet e shtruar për ndryshimin e praktikës së unifikuar gjyqësore, përfundimisht kërkohet nga Kolegjet e Bashkuara miratimi i vendimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për personin nën hetim Begtash Zeneli.

III. Vlerësimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

13. Kolegjet e Bashkuara çmojnë të nevojshme të sqarojnë paraprakisht se vendimi unifikues nr. 7/2011, si çdo vendim me funksion njësuës, nuk mund të lexohet në mënyrë të fragmentuar, sikur vlera e tij kufizohet vetëm te pjesët e evidentuara në mënyrë të veçuar ose në përfundimet ku formulohet rregulli i së drejtës. Vendimi gjyqësor përbën një akt të vetëm logjiko-juridik, në të cilin arsyetimi dhe përfundimet njësuëse janë të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën dhe duhet të kuptohen në funksion të “*ratio decidendi*” të vendimit. Për rrjedhojë, forca orientuese dhe detyruese e vendimit njësuës nuk buron nga mënyra e paraqitjes formale të disa paragrafëve, por nga përmbajtja e arsyetimit që është e domosdoshme për të kuptuar rregullin e së drejtës të formuluar nga Kolegjet e Bashkuara, kufijtë e zbatimit të tij dhe metodologjinë që gjykatat duhet të ndjekin.

14. Kjo mënyrë e leximit të vendimit gjyqësor si një i tërë gjen mbështetje edhe në jurisprudencën kushtetuese dhe konventore. Në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se vendimi gjyqësor, në tërësinë e tij, duhet konsideruar si një unitet, ku pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe vihen në shërbim e në funksion të njëra-tjetrës (*shih*

vendimet nr. 3, datë 23.01.2024, nr. 20, datë 13.04.2012, nr. 38, datë 30.12.2010, të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se pjesa arsyetuese duhet të lidhet logjikisht me përfundimin e arritur në dispozitiv. Në të njëjtën linjë, jurisprudenca e GJEDNJ kërkon që gjykatat vendase të tregojnë me qartësi të mjaftueshme bazën arsyetuese të vendimeve të tyre (*shih vendimet García Ruiz k. Spanjës Aplikimi nr. 30544/96 (21 janar 1999); Ruiz Torija k. Spanjës Aplikimi, nr. 18390/91 (9 dhjetor 1994); Hadjianastassiou k. Greqisë Aplikim nr. 12945/87 (16 dhjetor 1992)*). Kjo tregon se arsyetimi nuk është element dytësor apo thjesht shpjegues, por pjesë përbërëse e vetë standardit të rregullsisë dhe kontrollueshmërisë së vendimit gjyqësor.

15. Mbi këtë premisë duhet kuptuar edhe objekti i rishqyrtimit të pjesshëm të praktikës së mëparshme unifikuere. Në rastin konkret, ky shqyrtim nuk drejtohet ndaj sentencave unifikuere të vendimit nr. 7/2011, të cilat mbeten të paprekura, por ndaj nevojës për qartësimin dhe saktësimin e atyre pjesëve të arsyetimit që kanë evidentuar pasiguri në interpretim ose zbatime jo të njëtrajtshme në praktikë. Ky qartësim është i nevojshëm për të shmangur një lexim të pjesshëm të vendimit unifikues dhe për të garantuar zbatimin e tij në përputhje me kuadrin aktual ligjor dhe konventor.

16. Pas paraqitjes së çështjeve të shtruara në vendimin e ndërmjetëm dhe dëgjimit të qëndrimeve të palëve, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se procedura e nisur me vendimin e ndërmjetëm të Kryetarit të Gjykatës së Lartë ka shërbyer për ushtrimin e mekanizmit të parashikuar nga ligji për rishqyrtimin e praktikës së mëparshme unifikuere. Ky rishqyrtim është i nevojshëm me qëllim verifikimin e nevojës për qartësimin e standardeve të zbatimit të neneve: 228 (kushtet e përgjithshme të caktimit të masave të sigurimit personal); 229 (kriteret e përzgjedhjes së këtyre masave); 230/1 kriteri i aplikimit të masës së sigurimit personal të “arrestit në burg”, si *extrema/ultima ratio* dhe e lidhur ngushtë me detyrimin e përcaktuar në nenin 245/1, shkronja “ç” të KPP, ku veçanërisht në rastet kur caktohet një prej masave paraburgosëse, të parashikuara në nenet 237, 238 dhe 239 të KPP, për të arsyetuar realisht papërshtatshmërinë e zbatimit të masave tjera të sigurimit.

17. Mbi këtë bazë, Kolegjet çmojnë paraprakisht se natyra e ndërhyrjes nuk përcaktohet nga emërtimi formal i procedurës, por nga përmbajtja reale e formulimeve që kërkojnë qartësim dhe nga efekti që saktësimi i tyre mund të prodhojë mbi standardin. Në këtë fazë, Kolegjet theksojnë se rishqyrtimi i vendimit unifikues nr. 7/2011 nuk synon mohimin e vlerës së tij orientuese dhe as ndryshimin e sentencave unifikuere, por verifikimin nëse disa formulime të pjesës arsyetuese kërkojnë qartësim, saktësim, standardizim, ndryshim ose zhvillim të mëtejshëm, për shkak të hapësirës që mund të kenë krijuar për kuptime jo të njëtrajtshme në praktikë. Në këtë mënyrë, ky mekanizëm procedural shërben për të forcuar vijimësinë, koherencën dhe përshtatjen e praktikës gjyqësore me standardet aktuale ligjore e konventore.

18. Këto formulime lidhen, në thelb, me tre aspekte të caktimit dhe vijimit të masës së sigurimit “arrest në burg”, shqyrtimin real të masave alternative, vlerësimin konkret e të individualizuar të rrezikshmërisë së veprës dhe të personit, si dhe barrën e justifikimit të nevojës për caktimin ose vijimin e kësaj mase. Nuk bëhet fjalë për çështje thjesht redaktoriale ose për ndryshim terminologjik të praktikës së mëparshme, por për standarde që lidhen drejtpërdrejt me kufijtë e lejueshëm të kufizimit të lirisë personale dhe me cilësinë e kontrollit gjyqësor mbi këtë kufizim. Pikërisht në këto drejtime, zhvillimet ligjore pas vitit 2011, veçanërisht nenet 228/3/a, 244/1 dhe 245/1/ç të KPP, si edhe standardet e konsoliduara të GJEDNJ mbi kufizimin e lirisë personale, kanë përforcuar kërkesën për arsyetim real, të posaçëm dhe të kontrollueshëm, duke shtruar nevojën për të vlerësuar nëse formulimet e praktikës së mëparshme mund të lexohen në mënyrë të tillë që të lejojnë një arsyetim të përgjithshëm, formal ose të mbështetur kryesisht në natyrën e

veprës penale. Prandaj, nevoja për ndërhyrje në arsyetimin e vendimit unifikues nr. 7/2011 buron nga detyrimi për ta harmonizuar zbatimin e neneve 228-230 të KPP me standardin aktual ligjor dhe konventor, i cili kërkon nga gjykatat një arsyetim më konkret, më të individualizuar dhe më të verifikueshëm në çdo rast.

19. Në këtë kuptim, rishqyrtimi i pjesshëm i praktikës duhet kuptuar jo si shkëputje nga standardi i mëparshëm, por si mundësi për zhvillimin dhe përshtatjen e tij, për aq sa ai standard duhet të lexohet dhe të zbatohet në përputhje me kuadrin aktual ligjor dhe konventor. Mekanizmi procedural i nismës për ndryshimin e praktikës ka shërbyer, në rastin konkret, për të mundësuar këtë rivlerësim interpretues dhe për ta orientuar praktikën drejt një kuptimi më të qartë, më të qëndrueshëm dhe më të parashikueshëm. Ky rishqyrtim nuk synon të zëvendësojë standardin e mëparshëm në tërësi, por të përcaktojë nëse dhe në çfarë mase ai duhet të përpunohet në ato pjesë të arsyetimit ku zbatimi praktik ka treguar nevojë për saktësim. Ky zhvillim mbetet i kufizuar vetëm në formulimet e pjesës arsyetuese të evidentuara më sipër dhe duhet lexuar në harmoni me sentencat njësuere ekzistuese. Ai nuk prek pjesën tjetër të arsyetimit apo sentencat njësuere të vendimit unifikues nr. 7/2011, të cilat mbeten të pandikuara nga ky saktësim.

20. Në vijim, Kolegjet e Bashkuara do të analizojnë veçmas çështjet e shtruara në vendimin e ndërmjetëm, duke përcaktuar, për secilën prej tyre, standardin që duhet të udhëheqë praktikën gjyqësore në zbatimin e neneve 228-230 dhe nenit 245, pika 1, shkronja “ç”, të KPP. Kjo mënyrë shqyrtimi i shërben ndarjes së qartë ndërmjet vlerësimit mbi nevojën për qartësim të praktikës së mëparshme dhe formulimit të rregullit të së drejtës për secilën çështje të shtruar.

21. Në zbatim të nenit 441, pika 2, të KPP, në rastet kur Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosin njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, ato formulojnë edhe rregullin e së drejtës për çdo çështje të shtruar për zgjidhje në vendimin e ndërmjetëm të marrë gjatë gjykimit të çështjes. Në rastin konkret, vendimi i ndërmjetëm i Kryetarit të Gjykatës së Lartë ka shtruar për zgjidhje këto çështje:

i. Në interpretim të neneve 228 dhe 230 të KPP, a është në përputhje me këto dispozita dhe me nenin 5 § 3 të KEDNJ qëndrimi sipas të cilit, kur kërkohet ose vendoset masa e “arrestit në burg”, gjykata nuk ka detyrim të analizojë realisht masat alternative dhe mjafton të arsyetojë se masa e zgjedhur prej saj është e përshtatshme për rastin konkret?

22. Në analizë të çështjes së parë, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se nga interpretimi sistematik dhe teleologjik i neneve 228, 229, 230, 244, pika 1 dhe 245, pika 1, shkronja “ç”, të KPP, rezulton se masa e sigurimit arrest në burg nuk përbën masë të zakonshme të sigurimit personal, por masën më të rëndë, e cila mund të vendoset vetëm kur, mbi bazën e një vlerësimi të shprehur, të individualizuar dhe të mbështetur në fakte dhe rrethana të posaçme të çështjes, provohet se çdo masë tjetër është e papërshtatshme për përmbushjen e nevojave të sigurimit. Në këtë kuptim, kuadri ligjor për caktimin e masës së sigurimit personal kërkon plotësimin në mënyrë kumulative të këtyre kushteve dhe kriterëve: ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, të bazuar në prova (neni 228, pika 1 KPP); mungesën e shkaqeve të padënueshmërisë, të shuarjes së veprës penale ose të shuarjes së dënimit (neni 228, pika 2 KPP); ekzistencën e të paktës njërit prej rreziqeve për nevojat e sigurimit (neni 228, pika 3 KPP), si dhe përzgjedhjen e asaj mase të sigurimit personal që, në raport me këto rreziqe, garanton në mënyrë proporcionale dhe të përshtatshme përmbushjen e nevojave të sigurimit në rastin konkret (neni 229 KPP). Në vijim, formulimi i nenit 230 të KPP, sipas të cilit arresti në burg mund të caktohet vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme, nuk mund të kuptohet si një dispozitë thjesht deklarative, por si një detyrim konkret për gjykatën që të kryejë një vlerësim real, krahasues dhe të individualizuar të masave alternative, më pak

kufizuese ndaj lirisë personale. Në mënyrë të veçantë, masa e sigurimit personal e “arrestit në burg”, konsiderohet, sipas përcaktimit të paragrafit të parë, të nenit 230 të KPP, si masa e fundit/extrema/*ultima ratio*, e cila mund të vendoset vetëm kur, çdo lloj mase tjetër rezulton e papërshtatshme për të garantuar nevojat e sigurimit të procedimit penal. Këto nevoja sigurimi identifikohen në përcaktimet e pikës së tretë (të paktën njërit prej tyre) të nenit 228 të KPP, të cilat nuk mund të garantohen/plotësohen nga asnjë lloj mase tjetër e ndryshme nga kjo masë kufizuese e lirisë, “arrestit në burg”.

23. Ky përfundim përforcohet edhe nga zhvillimet e mëvonshme ligjore. Me ndryshimet e bëra në KPP me ligjin nr. 35/2017, ligjvënësi ka vendosur një standard më të lartë arsytimi për vendimet që kufizojnë lirinë personale. Neni 244/1 kërkon që vendimi që cakton masën e sigurimit të jetë i arsytuar, ndërsa neni 245, pika 1, shkronja “ç”, e ka parashikuar si element të domosdoshëm të vlefshmërisë së vendimit që cakton masën e sigurimit, parashtrimin e shkaqeve përse nuk merren parasysh pretendimet e mbrojtjes, si dhe të arsyeve përse masat e tjera të sigurimit nuk janë të përshtatshme kur caktohen masat e sigurimit shtrënguese të parashikuara nga nenet 237, 238 dhe 239 të KPP. Kjo zgjedhje ligjore nuk ka karakter formal, por pasqyron një orientim të qartë të ligjvënësit për të forcuar kontrollin gjyqësor mbi domosdoshmërinë e kufizimit të lirisë dhe për të shmangur arsytimet stereotipe ose të përgjithshme.

24. Megjithatë, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se ky detyrim nuk duhet kuptuar si kërkesë për një trajtim nominal, të veçuar dhe mekanik të secilës masë alternative, në kuptimin që vlefshmëria e vendimit të varet nga ndarja formale e paragrafëve për “arrestin në shtëpi”, “detyrimin për paraqitje në policinë gjyqësore”, “garancinë pasurore” ose masa të tjera të sigurimit. Kuptimi i drejtë i nenit 245, pika 1, shkronja “ç” të KPP është se ai kërkon arsyetimin e papërshtatshmërisë së masave të tjera në substancë. Ky arsyetim duhet të bëjë të kontrollueshëm faktin se gjykata i ka marrë realisht në shqyrtim alternativat dhe i ka përjashtuar ato mbi bazën e rrethanave konkrete të çështjes. Në këtë kuptim, neni 245, pika 1, shkronja “ç” i KPP kërkon përmbajtje reale të arsyetimit dhe jo ndërtimin mekanik të paragrafëve të veçantë për secilën masë alternative. Prandaj, pas hyrjes në fuqi të këtij standardi të ri ligjor, një formulim sipas të cilit gjykata mund të shmangë analizën e papërshtatshmërisë së masave të tjera të sigurimit, bie ndesh jo vetëm me logjikën e neneve 228 - 230 të KPP, por edhe me kërkesat për arsyetimin që ligjvënësi ka vendosur si garanci kundër automatizmit në kufizimin e lirisë personale të parashikuar nga neni 245, pika 1, shkronja “ç” të KPP. Vetëm nëpërmjet një vendimi të arsytuar mund të sigurohet kontroll publik mbi administrimin e drejtësisë.

25. I njëjti përfundim del edhe nga jurisprudenca e konsoliduar e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim GJEDNJ), e cila ka vendosur një standard të qartë dhe të konsoliduar mbi detyrimin e gjykatave vendase për të shqyrtuar realisht masat alternative ndaj paraburgimit. Ky standard buron nga interpretimi i nenit 5, paragrafi 3 i KEDNJ, sipas të cilit prezumimi është gjithmonë në favor të lirisë, ndërsa paraburgimi përbën masën e fundit (*ultima ratio*) që kërkon arsye të veçanta. Në çështjen *Hysa kundër Shqipërisë*¹, GJEDNJ u ndal në mënyrë të posaçme të cilësia e arsyetimit të gjykatave vendase lidhur me alternativat ndaj paraburgimit. Ajo vërejti se vendimet vendase deklarorin se masat alternative ndaj paraburgimit konsideroheshin të papërshtatshme, megjithatë, përtej një deklaratë formale se masat e tjera ishin marrë në konsideratë, vendimet nuk i referoheshin në thelb shkallës së vlerësimit që gjykatat kishin treguar ndaj masave alternative (*Hysa kundër Shqipërisë*, § 76). Ky konstatim tregon se, për GJEDNJ, nuk mjafton vetëm përmendja formale e alternativave ndaj masës së sigurimit arresti në burg, por

¹ Kërkesa nr. 52048/16, vendim i 21 shkurtit 2023.

kërkohet që gjykatat të kenë kryer një analizë reale dhe thelbësore të tyre. Në të njëjtën çështje, GJEDNJ theksoi gjithashtu se çdo periudhë burgimi duhet të justifikohet në mënyrë bindëse, duke vendosur barrën e arsyetimit mbi autoritetet gjyqësore dhe jo mbi personin e privuar nga liria. (*Hysa kundër Shqipërisë*, § 63).

26. Në çështjen *Gëllçi kundër Shqipërisë*², GJEDNJ trajtoi pikërisht të njëjtën problematikë në kontekstin e një paraburgimi të zgjatur. Ajo konstatoi se gjykatat vendase nuk duhej që kishin vlerësuar siç duhej ndonjë masë alternative sigurie përtej një deklarimi thjesht formal, pavarësisht kërkesave të shumta të kërkuarit (*Gëllçi kundër Shqipërisë*, § 25). GJEDNJ konstatoi gjithashtu se argumente thelbësore të kërkuarit si, kthimi vullnetar në Shqipëri, dorëzimi vetë autoriteteve dhe lidhjet familjare e profesionale, nuk ishin peshuar siç duhej, ndërsa arsyetimi i gjykatave të brendshme nuk ishte shtjelluar për të reflektuar situatën në zhvillim (*Gëllçi kundër Shqipërisë*, § 24). Kjo e fundit tregon se gjykata nuk mund të mjaftohet me formulat e vendimit fillestar, por duhet të rivlerësojë masat e tjera alternative të paraburgimit në dritën e zhvillimeve të mundshme të procedimit penal.

27. Në të njëjtën linjë qëndron edhe çështja *Muçaj kundër Shqipërisë*³, ku GJEDNJ konstatoi se gjykatat vendase nuk kishin marrë në konsideratë ndonjë masë alternative sigurie përtej një deklarimi formal (*Muçaj kundër Shqipërisë*, § 22). GJEDNJ vuri në dukje se gjykatat vendase vijuan t'i referoheshin rrezikut për t'iu fshehur drejtësisë si arsye kryesore për paraburgimin e zgjatur, pa treguar se si ky rrezik gjente zbatim konkretisht në rastin e kërkuarit, ndërsa ritheksoi se serioziteti i veprës ose pasojat e saj nuk përbëjnë arsye të pavarura që justifikojnë ndalimin me burgim (*Muçaj kundër Shqipërisë*, § 22).

28. Po ashtu, në çështjen *Buzadji kundër Republikës së Moldavisë*⁴, GJEDNJ ka riafirmuar se çdo periudhë paraburgimi duhet të justifikohet në mënyrë relevante e të mjaftueshme dhe se autoritetet janë të detyruara të marrin në konsideratë masa alternative më pak kufizuese, (*Buzadji kundër Republikës së Moldavisë [DHM]*, § 87) madje që në fazat fillestare të procedimit, menjëherë pas arrestimit (*po aty*, § 102).

29. E njëjta qasje del edhe nga çështjet *Idalov kundër Rusisë*⁵ dhe *Vafiadis kundër Greqisë*⁶, ku GJEDNJ ka theksuar se mungesa e një analize reale të masave alternative dhe përdorimi i formulave të përgjithshme pa lidhje të drejtpërdrejta me faktet e rastit e bëjnë arsyetimin të pamjaftueshëm sipas nenit 5 § 3 të KEDNJ (Idalov, §§ 147–148; Vafiadis, §§ 51, 54). Po ashtu, në çështjen *Lelièvre kundër Belgjikës*⁷, edhe pse arsyet e refuzimit të lirimit mbetën relevante gjatë gjithë procedurës, GJEDNJ konstatoi se mosshqyrtimi serioz i masave alternative përgjatë një paraburgimi të zgjatur e bëri atë të pambështetur në arsye relevante dhe të mjaftueshme dhe tejkaloi afatin e arsyeshëm (Lelièvre, §§ 102, 108).

30. Për këto arsye, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se formulimi i vendimit unifikues nr. 7/2011, sipas të cilit, kur kërkohet ose vendoset masa e sigurimit arrest në burg, “... gjykata nuk ka detyrim që të analizojë përse llojet e tjera të masave të sigurimit nuk janë të përshtatshme, mjafton që të argumentojë se masa e caktuar prej saj në rastin konkret ndaj të gjykuarit është masa e përshtatshme ...”, ka nevojë për qartësim, saktësim, standardizim, ndryshim dhe zhvillim të mëtejshëm, pasi ky arsyetim lë të kuptohet se shqyrtimi i masave alternative ndaj arrestit në burg

² Kërkesa nr. 15468/23, vendim i 25 shkurtit 2025.

³ Kërkesa nr. 37814/10, vendim i 11 korrikut 2023.

⁴ Kërkesa nr. 23755/07, vendim i Dhomës së Madhe i 5 korrikut 2016.

⁵ Kërkesa nr. 5826/03, vendim i Dhomës së Madhe i 22 majit 2012.

⁶ Kërkesa nr. 24981/07, vendim i 2 korrikut 2009.

⁷ Kërkesa nr. 11287/03, vendim i 8 nëntorit 2007.

nuk përbën një element të detyrueshëm dhe thelbësor të arsytimit të vendimit, por një mundësi me karakter fakultativ për gjykatën. Për rrjedhojë, kur gjykata arsyeton në mënyrë të shprehur, konkrete dhe të individualizuar kushtet dhe kriteret e përgjithshme për caktimin e masës së sigurimit arrest në burg sipas neneve 228 e 229 të KPP; “rrezikshmërinë e veçantë të veprës dhe të pandehurit”, sipas nenit 230 të KPP, duke e lidhur atë me faktet dhe rrethanat e posaçme të rastit, ky arsyetim mund të përfshijë në vetvete, në mënyrë të integruar dhe funksionale, edhe përfundimin se masat e tjera më të lehta nuk janë të përshtatshme. Në këtë kuptim, neni 245, pika 1, shkronja “ç” i KPP kërkon përmbajtje reale të arsytimit dhe jo ndërtimin mekanik të paragrafëve të veçantë për secilën masë alternative. Vetëm kur “rrezikshmëria e veçantë” konstatohet në mënyrë të përgjithshme, përmes formulimeve standarde dhe pa një lidhje të qartë e të kuptueshme me papërshtatshmërinë e masave të tjera të sigurimit, arsyetimi konsiderohet në kundërshtim me këtë dispozitë, duke sjellë si pasojë pavlefshmërinë e vendimit, si sanksion të drejtpërdrejtë të mosrespektimit të këtij detyrimi arsyetimi (neni 245, pika 1 KPP).

31. Ndryshimet e bëra në KPP me ligjin nr. 35/2017 e kanë përforcuar këtë detyrim duke e shndërruar arsyetimin e papërshtatshmërisë së masave alternative (referuar pretendimeve të të hetuarit në raport me masën e sigurimit të kërkuar nga prokurori), nga një element dytësor në një kusht vlefshmërie të vetë vendimit, duke parashikuar pavlefshmërinë si pasojë të mosrespektimit të tij (neni 245, pika 1 e KPP). Po në të njëjtën linjë, jurisprudenca e GJEDNJ, si në çështjet shqiptare ashtu edhe në ato të Dhomës së Madhe për shtete të tjera, ka konsoliduar standardin sipas të cilit gjykatat kanë detyrimin pozitiv të shqyrtojnë realisht alternativat ndaj paraburgimit dhe se referimet thjesht formale ndaj tyre nuk mjaftojnë për të përmbushur kërkesat e nenit 5 të KEDNJ. Përkundrazi, masa e “arrestit në burg” mund të vendoset vetëm kur rezulton në mënyrë bindëse se masat më pak kufizuese nuk janë të mjaftueshme, në rrethanat konkrete të rastit, për të garantuar përmbushjen e nevojave emergjente të sigurimit të procedimit .

32. Nga ana tjetër, Kolegjet e Bashkuara theksojnë se ky qartësim dhe saktësim i arsytimit të vendimit unifikues nr.7/2011 nuk duhet kuptuar si orientim drejt një praktike të re me arsyetime skematike ose formulime standarde pa përmbajtje reale për secilën masë alternative sigurimi. Kërkesa e ligjit është që, nga përmbajtja e vendimit të arsyetuar, të rezultojë qartë dhe mbi bazën e elementeve konkrete të çështjes pse masa e arrestit në burg paraqitet si masa e vetme e përshtatshme dhe pse masat e tjera më pak kufizuese të lirisë nuk garantojnë në mënyrë efektive nevojat e sigurimit. Edhe standardi i vendosur nga GJEDNJ kërkon arsye relevante dhe të mjaftueshme për caktimin e paraburgimit dhe jo një arsyetim thjesht formal, të kufizuar në një paragraf standard për masat alternative të sigurimit. Për këtë arsye, arsyetimi për masat alternative të sigurimit, (të masave paraburgosëse të sigurimit), në raport me nevojat e sigurimit duhet të jetë i shprehur, i individualizuar dhe i mbështetur në fakte e rrethana të posaçme të çështjes, duke pasqyruar qartë rrezikun konkret, sipas nenit 228, pika 3, të KPP, si dhe domosdoshmërinë, përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin e kufizimit të lirisë nëpërmjet aplikimit të masës së sigurimit personal të “arrestit në burg”. Vetëm një argumentim i tillë në zbatim të kërkesave të neneve 228, 229, 230/1, 245, pika 1, shkronja “ç” të KPP dhe të paragrafit të parë, shkronja “c” dhe paragrafit të tretë të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, përmbush detyrimin e vlerësimit dhe arsytimit në substancë, si në lidhje me caktimin e masës së sigurimit ashtu edhe në raport me kohëzgjatjen e paraburgimit. Në këtë kuptim, detyrimi i gjykatës për të shqyrtuar masat alternative nuk kërkon katalogim ose renditje formale të secilës prej tyre, por përmbushet kur nga arsyetimi i vendimit rezulton në mënyrë të qartë dhe të kontrollueshme se, në rrethanat konkrete të çështjes, asnjë masë më pak kufizuese nuk është e aftë të garantojë nevojat e sigurimit. Për rrjedhojë, shqyrtimi dhe analiza e masave alternative nuk përbëjnë një element fakultativ të

arsyetimit, por pjesë të domosdoshme të vlerësimit që gjykata duhet të kryejë përpara caktimit ose vijimit të masës së sigurimit “arrest në burg”.

33. Në përgjigje të **çështjes së parë**, që lidhet me detyrimin e gjykatës për të shqyrtuar masat alternative përpara caktimit ose vijimit të masës “Arrest në burg”, Kolegjet e Bashkuara përcaktojnë këtë rregull të së drejtës:

“Qëndrimi i mbajtur në vendimin nr. 7/2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit, kur kërkohet ose vendoset masa e sigurimit “arrest në burg”, gjykata nuk ka detyrimin të analizojë realisht masat alternative dhe mjafton të arsyetojë se masa e zgjedhur është e përshtatshme për rastin konkret, nuk është në përputhje me nenet 228-230 dhe 245/1, shkronja “ç”, të Kodit të Procedurës Penale, si dhe me nenin 5 § 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në zbatim të neneve 228, 229, 230 dhe 245/1, shkronja “ç”, të Kodit të Procedurës Penale, gjykata ka detyrimin të shqyrtojë realisht masat e tjera më pak kufizuese të lirisë personale dhe të arsyetojë shprehimisht përse ato nuk janë të mjaftueshme në rastin konkret. Ky arsyetim duhet të jetë i shprehur, i individualizuar dhe i mbështetur në fakte e rrethana të posaçme të çështjes, duke pasqyruar qartë rrezikun konkret, sipas nenit 228, pika 3, të Kodit të Procedurës Penale, si dhe domosdoshmërinë, përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin e kufizimit të lirisë, në përputhje me standardet kushtetuese dhe konventore.”.

ii. Në interpretim të neneve 228 dhe 230 të KPP, a mund të nxirret “rrezikshmëria e veçantë e veprës dhe e të pandehurit”, si kriter për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” vetëm ose kryesisht nga natyra e veprës penale, nga rëndësia e saj e përgjithshme ose nga marzhi i dënimit, pa një vlerësim konkret dhe të individualizuar të rrethanave të rastit dhe të personit?

34. Në analizë të çështjes së dytë, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se shprehja “rrezikshmëria e veçantë e veprës dhe e të pandehurit”, e parashikuar në nenin 230 të KPP, nuk synon të anashkalojë dhe/apo përjashtojë në të njëjtën kohë, kushtet e caktimit dhe kriteret e përzgjedhjes së masave të sigurimit personal të përcaktuara në nenet 228 dhe 229 të KPP, përfshirë pa dallim dhe masën e sigurimit personal me karakter shtrëngues të “arrestit në burg”, të parashikuar nga neni 238 i KPP. Ky formulim ligjor, përmes lidhëzës “dhe” vendos detyrimin për një analizë të dyfishtë kumulative, i cili nuk mund të kufizohet në elementet abstrakte të figurës së veprës, por kërkon domosdoshmërisht ndërthurjen e elementeve të faktit penal (veprës penale) me rrethanat personale që karakterizojnë personin ndaj të cilit caktohet masa e sigurimit. Në këtë kuptim, neni 228 i KPP vendos standardin e ekzistencës së një rreziku real dhe të individualizuar, ndërsa neni 229 përcakton kriteret e proporcionalitetit dhe përshtatshmërisë së masës, duke kërkuar që kufizimi i lirisë të jetë i domosdoshëm në raport me nevojat e procedimit penal. Më tej, “arrestit në burg” caktohet në konformitet me përcaktimin e gjysmës së parë, të paragrafit të parë, të nenit 230 të KPP, në cilësinë e *extrema/ultima ratio*, në kushtet kur verifikohet se masat e tjera të ndryshme nga masa e “arrestit në burg”, të aplikuara edhe në mënyrë kumulative (dy ose më tepër masa në të njëjtën kohë), rezultojnë të papërshtatshme sipas përcaktimit të nenit 229/1 të KPP për garantimin e nevojave të sigurimit të evidentuara/sipas përcaktimit të paragrafit të tretë, të nenit 228 të KPP dhe në të njëjtën kohë, jo proporcionale me “rëndësinë faktit dhe sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete”, sipas përcaktimit të nenit 229/2 të këtij Kodi. Në të kundërt, “rrezikshmëria e veçantë e veprës dhe e të pandehurit” duhet cilësuar si një kriter për

caktimin e kësaj mase (arrestit në burg), krahas verifikimit të kushteve dhe kritereve të përzgjedhjes së masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues, përfshirë edhe këtë të fundit, të parashikuara nga nenet 228, 229, 230/1 (gjysma e parë, e paragrafit të parë, të kësaj dispozite).⁸

35. Këto kushte dhe kritere për caktimin e masave të sigurimit personal, përfshirë dhe masën e “arrestit në burg” imponojnë, në cilësinë e kushtit të përgjithshëm të aplikueshëm/të parashikuar në paragrafin e parë, të nenit 228 të KPP, verifikimin në radhë të parë të ekzistencës së “dysimit të arsyeshëm të bazuar në prova” në ngarkim të personit ndaj të cilit kërkohet të aplikohet masa, për kryerjen e një vepre penale”. Ky kusht, kur konkurren edhe me elemente të tjerë të identifikuar në: inekzistencën e shkaqeve të padënueshmërisë, shuarjes së veprës penale ose dënimit, përcaktimi i paragrafit të dytë, të nenit 228 të KPP; prezencën e njëjës prej nevojave të sigurimit të procedimit, të parashikuara në paragrafin e tretë, të nenit 228 të KPP; kriteret e përshtatshmërisë dhe të proporcionalitetit të parashikuara në paragrafët e parë dhe të dytë të nenit 229 të KPP; legjitimon gjykatën/gjyqtarin e hetimeve paraprake për caktimin, mbi kërkesën e prokurorit të masës së sigurimit personal të karakterit shtrëngues. Pra, duke i'u referuar përmbajtjes së dispozitave të sipërcituara, qartazi evidentohet se, ndërsa përmbajtja e paragrafit të parë dhe të dytë të nenit 228 të KPP tolerojnë një vlerësim paraprak të eventualitetit të prezencës së kushteve ligjore që mundësojnë caktimin e një mase sigurimi personal, paragrafi i tretë i kësaj dispozite, që përbën edhe elementin qendror të sistemit të caktimit të masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues të parashikuara në KPP lidhet me nevojat e sigurimit të parashikuara në atë paragraf, të cilat lejojnë verifikimin nëse kjo e fundit (masa e sigurimit) duhet të aplikohet.

36. Përmbajtja e tekstit të paragrafit të tretë, të nenit 228 të KPP, ka përshtatur parashikimet e nenit 5, të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilave masat e sigurimit personal me karakter shtrëngues mund të caktohen vetëm në rastet kur “verifikohen nevoja të patjetërsueshme lidhur me hetimet, ose nevoja të mbrojtjes së kolektivitetit për të ndaluar kryerjen e një krimi tjetër dhe për të parandaluar mundësinë e arratisjes”.

37. Konkretisht, sipas përcaktimit të shkronjës “a”, të paragrafit të tretë, të nenit 228 të KPP, që identifikon nevojën e sigurimit të procedimit prej “shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës”, Kolegjet e Bashkuara theksojnë se në funksion të verifikimit të kësaj nevoje sigurimi në cilësinë e kushtit të domosdoshëm për caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues, kumulativisht me kushtet e parashikuara në dy paragrafët e parë, të nenit 228 të KPP, gjykatat duhet të argumentojnë shkaqet e rëndësishme konkrete që i hetuari/personi ndaj të cilit kërkohet të caktohet masa, pengon marrjen ose vërtetësinë/gjenuinitetin e provës dhe në të njëjtën kohë, domosdoshmërinë dhe përshtatshmërinë e masës së caktuar në funksion të eliminimit të këtij rreziku.

38. Sakaq, sipas përcaktimit të shkronjës “b”, të paragrafit të tretë, të nenit 228 të KPP në cilësinë e nevojës së sigurimit të procedimit, evidentohet edhe eventualiteti i “largimit të të pandehurit/të hetuarit apo ekzistenca e rrezikut që ai mund të largohet”. Përsa i përket elementeve mbi të cilët duhet të bazohet gjykata/gjyqtari për hetimet paraprake në funksion të caktimit të masës së sigurimit personal për të identifikuar “rrezikun e largimit”, Kolegjet e Bashkuara konsiderojnë se duhet të nxirren nga elementë objektivë dhe konkret, të tilla si: mënyra e jetesës së subjektit, precedentët penale, procedime të tjera në ndjekje të regjistruara ndaj tij. Në këtë aspekt mund të konsiderohen të vlefshme në funksion të evidentimit të rrezikut të largimit edhe nga ekzaminimi i disa elementeve të faktit të lidhura midis tyre të tilla si: disponibiliteti prej të hetuarit i mjeteve për organizimin e arratisjes, burimeve ekonomike lehtësisht të sigurueshme, si dhe

⁸ 1. Arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme...

mundësinë e marrëdhënieve me persona dhe organizata të cilat mund të bashkëpunojnë me të për realizimin e arratisjes.

39. Shkronja “c”, e paragrafit të tretë, të nenit 228 të KPP, që parashikon të ashtuquajturën “nevojë sigurimi” justifikuese/garantuese të “mbrojtjes së interesit të kolektivitetit/komunitetit” prej “rrezikut që i pandehuri/i hetuari për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të kryejë krime të rënda apo të të njëjtit lloj me atë me të cilin procedohet”, ndryshe nga nevojat e sigurimit të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të paragrafit të tretë, të nenit 228 të KPP, nuk përgjigjet për nevojat e sigurimit të procesit penal, por sikurse u sipërcitua justifikohet nga motive të parandalimit social. Përmbajtja e këtij rreziku dhe e konkretësisë së tij, që i hetuari/personi ndaj të cilit kërkohet të caktohet masa e sigurimit personal të mund të kryejë “krime të rënda apo të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet”, duhet të vlerësohet bazuar në rrethanat e faktit dhe në raport me personalitetin e të hetuarit.

40. Kolegjet e Bashkuara ritheksojnë se gjykata/gjyqtari për hetimet paraprake, në eventualitetin e verifikimit të pranisë së kushteve të parashikuara në dy paragrafët e parë të nenit 228 të KPP dhe të njëres prej nevojave të sigurimit të parashikuara në paragrafin e tretë të kësaj dispozite, ka detyrimin e caktimit të një mase sigurimi personal me karakter shtrëngues të parashikuar në nenin 232 të KPP. Në vijim, theksohet se kjo masë sigurimi do të përcaktohet/individualizohet, në konformitet me përcaktimet e nenit 229/1 të KPP, në varësi të përmbushjes të nevojës konkrete të sigurimit të identifikuar dhe, në të njëjtën kohë, në konformitet me përcaktimet e paragrafit të dytë, të nenit 229 të KPP, në proporcion me “rëndësinë e faktit penal të atribuar të hetuarit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën konkrete, duke mbajtur parasysh edhe vazhdimësinë, përsëritjen, rrethanat lehtësuese dhe rënduese”. Në terma të tjerë, me verifikimin e kushteve të sipërcituara gjykata/gjyqtari për hetimet paraprake, në individualizimin e masës së sigurimit personal të përshtatshme në funksion të garantimit të nevojave të sigurimit të evidentuara dhe proporcionale në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete që i atribuohet të hetuarit, duke respektuar parimin e gradualitetit në caktimin/përzgjedhjen e llojit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues dhe në mënyrë të veçantë, atë të parashikuar në paragrafin e parë, të nenit 230 të KPP, që parashikon aplikimin e masës së sigurimit personal të “arrestit në burg”, të parashikuar në nenin 238 të KPP, si *extrema/ultima ratio*, disponon një hapësirë vlerësimi për të zbatuar çdo lloj mase të sigurimit personal të parashikuar në nenin 232 të KPP.

41. Nga ana tjetër, analiza e nenit 230 të KPP tregon se “rrezikshmëria e veçantë e veprës” presupozon një rrezik të shtuar, duke kërkuar që vepra penale, për shkak të rrethanave konkrete të kryerjes së saj, të paraqesë një intensitet të tillë rreziku, saqë masat e tjera më pak kufizuese të mos rezultojnë të mjaftueshme për garantimin e nevojave të sigurimit. Por, ky kriter nuk mund të nxirret *a priori* nga natyra e veprës ose nga marzhi i dënimit të parashikuar, por duhet të rezultojë nga një analizë konkrete e faktit penal. Megjithatë, ligji përjashton çdo arsyetim automatik të bazuar vetëm në natyrën e veprës, rëndësinë e saj të përgjithshme ose marzhin e dënimit. Për këtë arsye, natyra e veprës, mënyra e kryerjes së saj, pasojat e ardhura prej saj mund të shërbejnë si tregues të rëndësishëm, por nuk mund të konsiderohen të vetme, si të mjaftueshme për të nxjerrë përfundimin mbi ekzistencën e rrezikshmërisë së veçantë të veprës penale.

42. Edhe në lidhje me rrezikshmërinë e veçantë të pandehurit, përfundimet mund të arrihen vetëm nëse të dhënat e faktit penal lidhen dhe analizohen në raport me rrethana konkrete që karakterizojnë autorin, si sjellja e tij para dhe pas kryerjes së veprës, qëndrueshmëria e lidhjeve familjare dhe shoqërore, historiku personal, qëndrimi ndaj procesit penal, si dhe çdo element tjetër

që mund të japë të dhëna mbi ekzistencën e një rreziku real procedural ose shoqëror që ai paraqet në çështjen konkrete.

43. Në këtë kuptim, rrezikshmëria e veçantë e veprës penale nuk mund të analizohet e shkëputur nga rrezikshmëria e të pandehurit, por në ndërveprim të ngushtë me të. Ajo nuk identifikohet as me rrezikshmërinë abstrakte të veprës të përcaktuar nga ligjvënësi, as me ekzistencën e thjeshtë të dyshimit për kryerjen e saj. Ky vlerësim nuk mund të mbështetet në prezumime të përgjithshme ose në formula standarde të lidhura vetëm me natyrën e veprës, por duhet të bazohet në elemente faktike të verifikueshme që lidhen me personalitetin, historikun dhe sjelljen konkrete të autorit. Megjithatë, edhe në prani të këtyre elementëve, gjykata është e detyruar të verifikojë në mënyrë konkrete nëse rreziku i konstatuar mund të garantohet përmes masave më pak kufizuese të lirisë, pasi vetëm papërshtatshmëria e tyre, e arsytuar në mënyrë të shprehur, mund të justifikojë përfundimin se rrezikshmëria e autorit arrin atë nivel që kërkon caktimin e masës së arrestit në burg.

44. Ky qëndrim mbështetet edhe në jurisprudencën e GJEDNJ, e cila ka konsoliduar standardin sipas të cilit rëndësia abstrakte e veprës penale ose ashpërsia e dënimit të parashikuar nuk përbëjnë, në vetvete, arsye të mjaftueshme për të justifikuar paraburgimin. GJEDNJ ka përcaktuar një standard ku kërkohet arsyetim konkret, i individualizuar dhe i mbështetur në rrethana specifike të rastit dhe të personit për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”. Në çështjen *Hysa kundër Shqipërisë*, GJEDNJ konstatoi se vendimet e gjykatave vendase ishin bazuar në një masë të madhe në pasojat e rënda financiare të veprës dhe në faktin se kërkuesja dyshohej se e kishte kryer atë duke abuzuar me funksionin publik. Megjithatë, GJEDNJ theksoi shprehimisht se rëndësia e veprës ose pasojat e saj nuk përbëjnë arsye të pavarura që justifikojnë paraburgimin (*Hysa kundër Shqipërisë*, § 74). Po ashtu, GJEDNJ rikonfirmoi standardin se argumentet e gjykatave vendase në favor të dhe kundër lirimit nuk duhet të jenë të përgjithshme dhe abstrakte, por të përmbajnë referenca për fakte specifike dhe rrethana personale që justifikojnë paraburgimin e kërkuesit (*Hysa kundër Shqipërisë*, § 68).

45. Në çështjen *Muçaj kundër Shqipërisë*, GJEDNJ ritheksoi se serioziteti i veprës ose pasojat e saj nuk përbëjnë arsye të pavarura që justifikojnë ndalimin me burgim (*Muçaj kundër Shqipërisë*, § 22). Edhe në çështjen *Gëllçi kundër Shqipërisë*, GJEDNJ konstatoi se gjykatat vendase kishin përdorur formulime të përgjithshme për rrezikun e manipulimit të provave dhe kërcënimit të dëshmitarëve. GJEDNJ theksoi se nuk mund të pranohet pretendimi i qeverisë në mungesë të provave faktike konkrete mbështetëse ose të ndonjë indicieje për tentativën aktuale për t'u përfshirë në manipulimin e provave (*Gëllçi kundër Shqipërisë*, § 23). Gjithashtu, GJEDNJ konstatoi se argumente thelbësore të kërkuesit si kthimi vullnetar në Shqipëri, vetë dorëzimi tek autoritetet, lidhjet familjare dhe profesionale nuk ishin peshuar siç duhej, ndërsa arsyetimi i gjykatave të brendshme nuk ishte shtjelluar për të reflektuar situatën në zhvillim (*Gëllçi kundër Shqipërisë*, § 24).

46. Standardi i konsoliduar i GJEDNJ e përforcon këtë qasje edhe në çështje të tjera. Në çështjen *Buzadji kundër Republikës së Moldavisë*⁹, GJEDNJ konstatoi se arsyet e paraqitura nga gjykatat vendase ishin “stereotipe dhe abstrakte”, duke shtuar se vendimet citonin shkaqet e paraburgimit pa asnjë përpjekje për të treguar se si ato zbatoheshin konkretisht në rrethanat specifike të çështjes së kërkuesit (*Buzadji kundër Republikës së Moldavisë* [DHM], § 122). GJEDNJ theksoi se kur është në diskutim një e drejtë aq e rëndësishme sa liria personale, u takon autoriteteve vendase të tregojnë në mënyrë bindëse se paraburgimi është i domosdoshëm, (*Buzadji*

⁹ Kërkesa nr. 23755/07, vendim i 5 korrikut 2016.

kundër Republikës së Moldavisë [DHM], § 122); për rrjedhojë, individualizimi nuk është një kërkesë formale, por thelbi i kontrollit gjyqësor sipas nenit 5 § 3.

47. Po kështu, në çështjen *Ilijkov kundër Bullgarisë*¹⁰, GJEDNJ trajtoi në mënyrë të drejtpërdrejtë çështjen e raportit ndërmjet rëndësisë së akuzës dhe justifikimit të paraburgimit. GJEDNJ theksoi se rëndësia e akuzave nuk mund, në vetvete, të shërbejë për të justifikuar periudha të gjata paraburgimi (*Ilijkov kundër Bullgarisë*, § 81). GJEDNJ shkoi edhe një hap përtej duke konstatuar se çdo sistem i paraburgimit të detyruar është *per se* i papajtueshëm me nenin 5 § 3 të Konventës (*po aty*, § 84).

48. Nga kjo jurisprudencë del se gjykata nuk mund të kufizohet te natyra dhe rëndësia e përgjithshme e veprës penale, por duhet të argumentojë në mënyrë të individualizuar rrezikun që paraqet personi konkret në raport me nevojat e procedimit penal. Ajo përjashton gjithashtu çdo qasje që do të trajtonte marzhin e dënimit si element të mjaftueshëm për të provuar “rrezikshmërinë e veçantë”, pasi një arsyetim i tillë do ta zhvendoste vendimmarrjen nga kontrolli konkret gjyqësor drejt prezumimeve abstrakte.

49. Sa më i individualizuar dhe i mbështetur në fakte të jetë ky vlerësim, aq më qartë del lidhja ndërmjet rrezikshmërisë së veçantë dhe nevojës për caktimin e masës më të rëndë (arresti në burg). Për këtë arsye, analiza e kërkuar nga neni 230 nuk është e shkëputur nga analiza e kërkuar nga neni 245, pika 1, shkronja “ç” (ndryshuar me ligjin nr. 35/2017), por e ndërthurur me të. Në këtë kuptim, nëse rrezikshmëria e veçantë arsyetohet mbi elemente konkrete të faktit penal dhe të personit, atëherë, në të njëjtën kohë, gjykata jep edhe arsyet pse masat e tjera më pak kufizuese nuk mjaftojnë. Vetëm një arsyetim i tillë shmang si automatizmin në caktimin e masës së arrestit në burg, ashtu edhe vendimmarrjen në dukje të arsyetuar, por të mbështetur në formulime të përgjithshme dhe pa përmbajtje konkrete.

50. Për këto arsye, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se formulimi i vendimit unifikues nr. 7/2011, sipas të cilit, në rastin e procedimeve penale për krime të rënda apo që kanë sjellë pasojë të rënda, “... për vetë natyrën e këtyre veprave penale, të mënyrës së kryerjes e të pasojës së ardhur, është i pranishëm elementi i shkallës së lartë apo të rëndësishme të rrezikshmërisë së autorit të tyre sipas nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale ...”, ka nevojë për qartësim, saktësim, standardizim, ndryshim dhe zhvillim të mëtejshëm. Kolegjet e Bashkuara theksojnë se, në caktimin e masës së sigurimit ‘arrest në burg’, prokurori fillimisht dhe gjykatat në vijim, kanë detyrimin të japin një arsyetim të individualizuar, të mbështetur në fakte e rrethana të posaçme të çështjes konkrete. Në këtë drejtim, Kolegjet theksojnë se edhe vlerësimi i rrezikshmërisë së veçantë duhet të jetë domosdoshmërisht i individualizuar (i mbështetur në fakte e rrethana të posaçme të çështjes) dhe të përfshijë jo vetëm elementet konkrete të faktit penal si natyra e veprës, mënyra e kryerjes, pasojat, por edhe elementet konkrete që lidhen me personin si sjellja para dhe pas veprës, precedentët penalë, lidhjet familjare dhe shoqërore, stabiliteti social, rreziku i cenimit ose ndikimit mbi provën, rreziku i largimit, i përsëritjes së veprës, si dhe çdo faktor tjetër i rëndësishëm për vlerësimin e rrezikut procedural ose shoqëror të autorit. Vetëm kur verifikohen dhe vërtetohen këto elemente në mënyrë të plotë dhe të individualizuar, duke provuar rrezikshmërinë e veçantë të veprës dhe të autorit në kuptim të nenit 230, pika 1 të KPP, masa e sigurimit “arrest në burg” përlligjet si masa më e përshtatshme që garanton nevojat e sigurimit. Prandaj, paraburgimi mund të justifikohet në një rast të caktuar vetëm nëse ekzistojnë tregues specifikë të një kërkesë të vërtetë të interesit publik. Në këtë kuptim, analiza e kërkuar nga neni 230 i KPP është ngushtësisht e lidhur me atë të nenit 245, pika 1, shkronja “ç” të KPP, pasi vetëm një arsyetim që evidenton në mënyrë

¹⁰ Kërkesa nr. 33977/96, vendim i 26 korrikut 2001.

konkrete papërshtatshmërinë e masave alternative mund të legjitimojë kufizimin më të rëndë të lirisë. Ky standard përputhet plotësisht edhe me jurisprudencën e GJEDNJ, e cila kërkon që gjykatat të analizojnë realisht alternativat ndaj paraburgimit dhe të shmangin arsyetimet stereotipe ose abstrakte.

51. Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, nëse mbajtja e një personi në paraburgim është e arsyeshme dhe e domosdoshme, kjo duhet të vlerësohet mbi bazën e fakteve të çdo rasti dhe sipas veçorive të tij specifike. Vetëm një vlerësim i tillë i plotë dhe i individualizuar i përgjigjet kërkesave të ligjit procedural penal dhe standardeve konventore, nga i cili rrjedh edhe rregulli i së drejtës i formuluar më poshtë.

52. Në përgjigje të **çështjes së dytë**, që lidhet me mënyrën e vlerësimit të rrezikshmërisë së veprës dhe të autorit në raport me masën “arrest në burg”, Kolegjet e Bashkuara përcaktojnë këtë rregull të së drejtës:

“Caktimi i masës arrest në burg ka natyrë përjashtimore dhe mund të vendoset vetëm kur masat e tjera janë të papërshtatshme, në raport me kushtet dhe kriteret e parashikuara në nenet 228 e 229 të Kodit të Procedurës Penale. Në caktimin e masës arrest në burg, prokurori fillimisht dhe gjykatat në vijim kanë detyrimin të japin një arsyetim të individualizuar, të mbështetur në fakte e rrethana të posaçme të çështjes që lidh nevojën e kësaj mase me rrezikshmërinë e veprës dhe të autorit në rastin konkret. Ky vlerësim duhet të mbështetet në rrethanat specifike të faktit, në mënyrën e kryerjes së veprës dhe në të dhënat që lidhen me personin ndaj të cilit caktohet masa e sigurimit, përfshirë personalitetin, sjelljen, rrethanat individuale e familjare, si dhe çdo tregues tjetër të rëndësishëm për vlerësimin e rrezikut real procedural ose shoqëror që ai paraqet në çështjen konkrete.

Kur verifikohet rrezikshmëria e veçantë e veprës dhe e autorit, në kuptim të nenit 230, pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, masa e sigurimit “arrest në burg” përlligjet si masa më e përshtatshme, që garanton nevojat e sigurimit. Rrezikshmëria e veçantë e veprës dhe e autorit nuk nxirret vetëm ose kryesisht nga natyra e krimit ose nga marzhi i dënimit, por nga vlerësimi i ndërthurur i rrezikshmërisë së veçantë të faktit penal, i mënyrës së kryerjes, pasojave të ardhura, i personalitetit të të pandehurit, i sjelljes së tij, si dhe i rrethanave të tjera të rëndësishme dhe të lidhura ndërmjet tyre për rastin konkret.”.

iii. Kujt i takon barra e justifikimit të nevojës për caktimin dhe vijimin e masës së “arrestit në burg” dhe a është në përputhje me nenin 5 § 3 të KEDNJ dhe me nenet 228-230 të KPP qëndrimi sipas së cilit papërshtatshmëria e kësaj mase mund të pranohet vetëm nëse i pandehuri paraqet prova pozitive?

53. Në analizë të çështjes së tretë, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se, nga interpretimi sistematik dhe teleologjik i neneve 228, 229, 230 dhe 244 të KPP, në lidhje me nenin 5, paragrafi 3 të KEDNJ, rezulton se barra e justifikimit të nevojës për caktimin dhe vijimin e masës së sigurimit “arrest në burg” i takon organit të akuzës, i cili kërkon ose mbron këtë kufizim të lirisë personale, ndërsa gjykata ka detyrimin ta verifikojë këtë nevojë në mënyrë efektive, të pavarur dhe të arsyetuar. Ky përfundim buron nga vetë natyra e masës së arrestit në burg, e cila mund të caktohet vetëm kur rezulton absolutisht e domosdoshme për mbrojtjen e interesit publik, si dhe nga parimi sipas të cilit liria personale përbën rregull, ndërsa kufizimi i saj përbën përjashtim.

54. Nga interpretimi sistematik i dispozitave të KPP rezulton se barra për justifikimin e caktimit të masës së sigurimit “arrest në burg” i takon organit të akuzës. Kjo rrjedh drejtpërdrejt

nga neni 244 i KPP, sipas të cilit masa vendoset mbi kërkesën e prokurorit, i cili ka detyrimin të paraqesë arsyet ku bazohet kërkesa e tij. Në këtë kuptim, prokuroria nuk kufizohet në paraqitjen formale të kërkesës, por duhet të provojë ekzistencën e të gjitha kushteve dhe kritereve ligjore, nëpërmjet provave të marra sipas nenit 149 e vijues të KPP, të cilat duhet të jenë marrë në përputhje me ligjin dhe të jenë të afta për të vërtetuar faktet relevante për vendimmarrjen. Nenet 228 dhe 229 parashikojnë kushtet dhe kriteret që duhet të provohen nga prokuroria, përkatësisht ekzistenca e një dyshimi të arsyeshëm të bazuar në prova dhe praninë e njërit prej rreziqeve procedurale. Duke qenë se këto elemente përbëjnë premisat ligjore për kufizimin e lirisë personale, barra për t'i provuar ato nuk mund të zhvendoset tek i pandehuri (autori). Përkundrazi, prokuroria duhet të paraqesë fakte konkrete dhe të verifikueshme që tregojnë rrezikun real të cenimit të provave, të largimit ose të përsëritjes së veprës penale, sipas nenit 228, pika 3 të KPP. Kjo do të thotë se organi i akuzës nuk mjaftohet me provimin e dyshimit të arsyeshëm dhe të një rreziku procedural, por duhet të argumentojë në mënyrë të veçantë dhe konkrete pse masat e tjera më pak kufizuese nuk janë të mjaftueshme për rastin konkret. Në mungesë të një analize të tillë krahasuese, kërkesa për arrest në burg mbetet e paplotë nga pikëpamja ligjore. Detyrimi i prokurorisë për të mbledhur dhe paraqitur prova nuk është i njëanshëm. Neni 8/a i KPP i imponon organit procedues detyrimin për të shqyrtuar si provat fajësuese, ashtu edhe ato në favor të të pandehurit. Ky standard forcon më tej barrën e prokurorisë, pasi ajo duhet të paraqesë një tablo të plotë dhe objektive të rrethanave të çështjes, duke përfshirë edhe elementet që mund të mbështesin aplikimin e një mase më të butë sigurimi.

55. Në kuptim të kuadrit ligjor në fuqi, mënyra e marrjes dhe shqyrtimit të provave në procesin penal është qartësisht e rregulluar dhe e formalizuar nga KPP. Neni 151 i KPP përcakton se gjatë fazës së hetimeve paraprake provat merren nga organi procedues, pra prokuroria, sipas rregullave të përcaktuara në Kod, ndërsa në gjykim ato merren me kërkesën e palëve, por gjithmonë brenda kufijve dhe procedurave të parashikuara nga ligji. Kjo do të thotë se provat bëhen pjesë e fashikullit dhe përdoren në vendimmarrje vetëm nëse janë marrë në mënyrën dhe format e lejuara nga ligji, në përputhje me nenet 149 dhe 150 të KPP mbi kuptimin dhe objektin e provës. Si rrjedhojë, edhe në këtë këndvështrim mundësia e të pandehurit (autorit) për të paraqitur prova është e kufizuar nga këto rregulla dhe nuk është e lirë në çdo formë, pasi prova të përdorshme janë vetëm ato që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij.

56. Megjithatë, fakti që në fazën e hetimeve paraprake provat merren nga organi procedues, pra prokuroria, sipas rregullave të përcaktuara në KPP, ndërsa në gjykim ato merren me kërkesë të palëve dhe brenda kufijve të ligjit procedural penal (neni 151 KPP), nuk kufizon të drejtën e të pandehurit (autorit) për të paraqitur prova që ai i vlerëson të rëndësishme për vendimmarrjen. Në kuadër të procedurës së marrjes në pyetje të personit të arrestuar, neni 248, pika 4 i KPP parashikon të drejtën e palëve për të paraqitur prova gjatë debatit gjyqësor (me përjashtim të provave me dëshmitarë), duke konfirmuar karakterin kontradiktor të këtij shqyrtimi dhe mundësinë efektive të mbrojtjes për të sjellë elemente provuese në mbështetje të qëndrimit të saj.

57. Në këtë kuptim, personi ndaj të cilit kërkohet caktimi ose vazhdimi i masës së sigurimit “arrest në burg” mund të paraqesë prova kryesisht në lidhje me rrethanat e tij personale, familjare, shëndetësore ose rrethana të tjera të ngjashme që lidhen me gjendjen e tij individuale, për shkak se këto janë të dhëna që njihen dhe disponohen prej tij, por ky rol mbetet thjesht argumentues dhe ndihmues në vlerësimin e gjykatës. Në asnjë rast ai nuk zëvendëson detyrimin e prokurorisë për të provuar, mbi bazën e provave të marra sipas rregullave të përcaktuara në KPP, ekzistencën e kushteve dhe kritereve për caktimin dhe vijimin e masës së arrestit në burg. Sikurse u tha më lart,

kjo nuk do të thotë se i pandehuri nuk ka rol në debatin gjyqësor mbi shqyrtimin e masës së sigurimit. Në respektim të parimit të kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve, ai ka të drejtë të paraqesë rrethana faktike personale, familjare, shëndetësore, profesionale, shoqërore ose rrethana të tjera të ngjashme që lidhen me gjendjen e tij individuale që mund të flasin në favor të një mase më pak kufizuese. Megjithatë, ky rol ka natyrë argumentuese dhe lidhet me faktet që ai vetë pretendon. Ai nuk shndërrohet në barrë për të justifikuar lirinë si të tillë. Elemente të tilla si vendbanimi i qëndrueshëm, lidhjet familjare, gjendja shëndetësore, marrëdhëniet e punës, mungesa e precedentëve penalë, sjellja pas ngjarjes, vetëparaqitja ose bashkëpunimi me organet proceduese e të tjera, mund të merren në konsideratë nga gjykata në kuadër të vlerësimit të proporcionalitetit dhe të përshtatshmërisë së masave alternative ndaj arrestit në burg. Por ato nuk e çlirojnë prokurorinë nga detyrimi i saj për të provuar dhe argumentuar nevojën konkrete për caktimin dhe vijimin e masës së sigurimit “arrest në burg”.

58. Lidhur me gjykatën, Kolegjet e Bashkuara vënë në dukje se, roli i saj nuk është pasiv. Nenet 151 dhe 248 të KPP kërkojnë që gjykata të verifikojë në mënyrë aktive ekzistencën e kushteve dhe kriterëve të caktimit të masës dhe nevojat e sigurimit, të parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të këtij Kodi, duke kontrolluar në mënyrë të pavarur provat dhe argumentet e paraqitura nga prokuroria. Megjithatë, ky detyrim verifikimi nuk e përmbys barrën e provës. Kjo për arsye se gjykata kontrollon dhe vlerëson, por nuk e zëvendëson prokurorinë në detyrimin e saj për të provuar nevojën e caktimit dhe vijimit të masës së sigurimit të arrestit në burg. Kërkesa për një arsyetim të individualizuar dhe të plotë konfirmohet edhe nga neni 245 i KPP, i cili e lidh vlefshmërinë e vendimit me paraqitjen e shkaqeve konkrete që justifikojnë masën dhe me arsyetimin pse nuk merren parasysh pretendimet e mbrojtjes dhe pse masat e tjera janë të papërshtatshme. Ky standard tregon se barra e provës mbi prokurorinë reflektohet drejtpërdrejt në detyrimin e gjykatës për të dhënë një arsyetim të bazuar mbi faktet e paraqitura prej saj. Edhe në fazat e mëtejshme të procedimit penal, barra e justifikimit vijon të mbetet mbi prokurorinë. Nga përmbajtja e neni 246, pika 6 të KPP rezulton se në mënyrë periodike dhe në çdo rivlerësim të masës, prokuroria duhet të informojë dhe të provojë se nevojat e sigurimit vazhdojnë të ekzistojnë. Kjo natyrë dinamike e masave të sigurimit përjashton çdo mundësi për vijim automatik të arrestit në burg mbi bazën e vendimit fillestar.

59. Ky interpretim është në përputhje me jurisprudencën e konsoliduar të GJEDNJ. Kjo e fundit e ka trajtuar çështjen e barrës së justifikimit duke përcaktuar në mënyrë të konsoliduar se barra e arsyetimit bie mbi autoritetet, jo mbi individin e privuar nga liria. Standardi më i drejtpërdrejtë mbi ndalimin e zhvendosjes së barrës gjendet në vendimin *Ilijkov kundër Bullgarisë*¹¹. Në këtë çështje, sistemi ligjor bullgar e mbështeste paraburgimin mbi rëndësinë e veprës penale dhe krijonte një prezumim që e detyronte të pandehurin të provonte pse nuk duhej mbajtur në paraburgim. GJEDNJ u shpreh se zhvendosja e barrës së provës tek personi i ndaluar në çështje të tilla është e barabartë me përmbysjen e rregullit të neni 5 të KEDNJ, një dispozitë e cila e bën paraburgimin një devijim përjashtimor nga e drejta e lirisë.

60. Në çështjen *Hysa kundër Shqipërisë*, GJEDNJ ripohoi të njëjtin standard. Në këtë çështje GJEDNJ u shpreh se justifikimi për çdo periudhë burgimi duhet të demonstrohet në mënyrë bindëse nga autoritetet. GJEDNJ theksoi se vijimi i një dyshimi të arsyeshëm është “*conditio sine qua non*” për vlefshmërinë e paraburgimit, por, pasi ka kaluar një kohë e caktuar, ai nuk është më i mjaftueshëm. Atëherë, Gjykata duhet të vlerësojë: së pari, nëse arsye të tjera të cituara nga autoritetet gjyqësore vijnë të justifikojnë privimin e lirisë; dhe së dyti, nëse autoritetet vendëse

¹¹ Kërkesa nr. 33977/96, vendim i 26 korrikut 2001.

kanë shfaqur kujdes të veçantë në realizimin e procesit (*Hysa kundër Shqipërisë*, § 63). Ky standard tregon se sa më shumë kalon koha, aq më e lartë bëhet barra e arsyetimit mbi autoritetet dhe aq më pak pranohet mbështetja në formulime standarde ose në vendimin fillestar.

61. Në çështjen *Gëllçi kundër Shqipërisë*, GJEDNJ theksoi se nuk mund të pranohet pretendimi i Qeverisë në mungesë të provave faktike konkrete mbështetëse ose të ndonjë indicieje aktuale (*Gëllçi kundër Shqipërisë*, § 23). Ky formulim tregon se barra e paraqitjes së provave konkrete mbi ekzistencën e rrezikut bie mbi shtetin, jo mbi individin. Kur shteti nuk arrin të paraqesë prova konkrete për rrezikun, paraburgimi nuk mund të justifikohet, pavarësisht rëndësisë së veprës. Gjithashtu, GJEDNJ konstatoi se, gjykatat vendase nuk kishin reflektuar zhvillimet e situatës procedurale, duke treguar se arsyetimi mbi paraburgimin nuk mund të mbetet statik por duhet të përditësohet (*po aty* § 24). Në çështjen *Merabishvili kundër Gjeorgjisë*¹², GJEDNJ konstatoi shkelje pikërisht sepse vendimi për zgjatjen e paraburgimit kishte bërë të qartë se i pandehuri duhej të provonte pse paraburgimi nuk ishte më i justifikuar, pra barra ishte zhvendosur në mënyrë të papërshtatshme tek i pandehuri. GJEDNJ ripohoi se neni 5 § 3 e vendos barrën mbi autoritetet dhe nuk lejon që ajo të zhvendoset, drejtpërdrejt ose tërthorazi, mbi personin e privuar nga liria (*Merabishvili kundër Gjeorgjisë* [DHM], § 234).

62. Kërkesa ndaj të pandehurit për të sjellë të dhëna në favor të një mase më të butë mund të ketë vlerë vetëm në raport me rrethanat faktike personale që ai vetë i pretendon, por jo si barrë për të rrëzuar domosdoshmërinë e masës së arrestit në burg. Po të pranohej e kundërta, kontrolli gjyqësor do të reduktohej në një verifikim pasiv të mungesës së kundërprovës, duke humbur funksionin e tij si garanci kundër kufizimit arbitrar të lirisë.

63. Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se qëndrimi i mbajtur në vendimin unifikues nr.7/2011 sipas të cilit, masa e sigurimit arrest në burg mund të çmohet e papërshtatshme “... vetëm nëse ai ose mbrojtësi i tij i paraqesin gjykatës prova pozitive që tregojnë se kjo gjendje rreziku nuk është e pranishme, apo që nuk është e pranishme në atë shkallë e rëndësi që të bëjë të zbatueshme masën e sigurimit arrest në burg ...”, ka nevojë për qartësim, saktësim, standardizim, ndryshim dhe zhvillim të mëtejshëm, pasi ky arsyetim lë të kuptohet se barra e kundërshtimit të rrezikut procedural zhvendoset mbi të pandehurin dhe mbrojtjen e tij, në kundërshtim me parimin e barrës së provës që i takon organit të akuzës. Një kuptim i tillë krijon rrezikun e vendosjes së një prezumimi në favor të paraburgimit, dobëson prezumimin e pafajësisë dhe zhvendos barrën e justifikimit të caktimit dhe vijimit të masës së arrestit në burg nga organi që kërkon kufizimin e lirisë tek personi që gëzon këtë të drejtë themelore. Ky formulim, në efektin e tij praktik, krijon keqinterpretime dhe një prezumim në favor të masës së sigurimit “arrest në burg”, duke zhvendosur barrën e kundërshtimit tek i pandehuri dhe duke përmbysur logjikën kushtetuese të kontrollit gjyqësor mbi lirinë personale. Në këtë mënyrë, kërkesa për “prova pozitive” nga ana e të pandehurit (autorit) rrezikon të kthejë standardin e vlerësimit nga një detyrim i organit të akuzës për të provuar domosdoshmërinë e privimit të lirisë, në një barrë të individit për të rrëzuar një gjendje rreziku të prezumuar, çka paraqet kontradiktë edhe në raport me pabarazinë e palëve në procesin penal dhe vështirësinë objektive të provës së fakteve negative në këtë kontekst. Në këtë kuptim, fokusi i kontrollit gjyqësor zhvendoset nga verifikimi aktiv i domosdoshmërisë së paraburgimit tek vlerësimi i mjaftueshmërisë së kundërshtimeve të mbrojtjes, duke cenuar funksionin garantues të gjykatës në mbrojtje të lirisë personale.

64. Kuptimi i drejtë i ligjit dhe i standardit konventor është se prokuroria mbart barrën për të justifikuar nevojën e caktimit ose vijimit të masës së sigurimit “arrest në burg”, gjykata ka

¹² Kërkesa nr. 72508/13, vendim i Dhomës së Madhe i 28 nëntorit 2017.

detyrimin për kontroll efektiv dhe arsyetim të bazuar në elemente konkrete të mjaftueshme dhe relevante, ndërsa i pandehuri ka vetëm barrën për të paraqitur ato rrethana faktike personale që ai i pretendon në favor të një mase më pak kufizuese. Ligji procedural penal nuk parashikon asnjë rregull sipas të cilit i dyshuari ka barrën për të provuar se pse ndaj tij nuk duhet të caktohet një masë sigurimi. Rrjedhojë logjike e kësaj strukture normative është se papërshtatshmëria e arrestit në burg nuk mund të kushtëzohet nga paraqitja e “provave pozitive” nga i pandehuri. Një qasje e tillë do të përmbyste logjikën themelore të procesit penal ku është organi procedues ai i cili duhet të paraqesë arsyet dhe provat me qëllim justifikimin e kufizimit të lirisë. Sikurse u evidentua nga jurisprudenca e GJEDNJ, veçanërisht nga vendimet e Dhomës së Madhe në çështjet *Buzadji dhe Merabishvili*, çdo sistem ose formulim që krijon qoftë edhe *de facto* një prezumim në favor të paraburgimit, duke e detyruar individin të provojë pse nuk duhet mbajtur në burg, përbën shkelje të brendshme strukturore të nenit 5 të KEDNJ. I pandehuri ka të drejtë të paraqesë rrethana personale në favor të tij, por kjo nuk e çliron prokurorinë nga detyrimi themelor për të provuar domosdoshmërinë konkrete të masës së arrestit në burg. Prokuroria justifikon nevojën për privimin e lirisë, ndërsa i dyshuari paraqet rrethanat që flasin në favor të masave alternative. Pasi këto rrethana janë paraqitur, gjykata ka detyrimin pozitiv t'i shqyrtojë, t'i peshojë dhe t'i integrojë në arsyetimin e saj duke treguar pse, edhe në prani të tyre, masa e arrestit në burg mbetet e vetmja e përshtatshme. Vetëm ky ekuilibër siguron që kontrolli gjyqësor mbi lirinë personale të mbetet substancial dhe joformal, në përputhje me nenin 5, paragrafi 3 të KEDNJ dhe nenet 228 - 230 të KPP, duke respektuar si të drejtën e individit për të ndikuar në vendimmarrje, ashtu edhe detyrimin e organit procedues për të justifikuar çdo kufizim të lirisë dhe duke çuar te rregulli i së drejtës që formulohet më poshtë.

65. Në përgjigje të **çështjes së tretë**, që lidhet me barrën e justifikimit të nevojës për caktimin ose vijimin e masës “arrest në burg”, Kolegjet e Bashkuara përcaktojnë këtë rregull të së drejtës:

“Në interpretim të neneve 228, 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale, në lidhje me nenin 5 § 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, barra e justifikimit të nevojës për caktimin dhe vijimin e masës së sigurimit “arrest në burg” i takon prokurorisë, ndërsa gjykata ka detyrimin ta verifikojë dhe ta arsyetojë atë në çdo fazë të procedimit. Prokuroria ka detyrimin të paraqesë dhe të argumentojë në mënyrë konkrete faktet dhe rrethanat që mbështesin nevojën e kësaj mase, përfshirë rrezikun konkret dhe papërshtatshmërinë e masave më pak kufizuese. Në vendimmarrjen e saj gjykata nuk mund të kushtëzohet nga paraqitja ose jo e “provave pozitive” nga i pandehuri. I pandehuri mban vetëm barrën e paraqitjes së rrethanave faktike personale, familjare, shëndetësore ose rrethanave të tjera, kur i ngre ato si argumente në favor të masave më pak kufizuese.”

66. Rregullat e së drejtës të formuluar në këtë vendim përbëjnë rezultatin konkret të ndërhyrjes së Kolegjeve të Bashkuara në praktikën e mëparshme unifikuese, në pjesën që lidhet me caktimin dhe vijimin e masës së sigurimit “arrest në burg”. Ato nuk ndryshojnë sentencat e vendimit unifikues nr. 7/2011, por saktësojnë, qartësojnë dhe zhvillojnë mënyrën e kuptimit të disa formulimeve të arsyetimit të tij, për aq sa ato kanë krijuar pasiguri interpretimi ose zbatime jo të njëtrajtshme në praktikë. Në këtë kuadër, praktika e mëparshme, në pjesën që lidhet me masën e sigurimit “arrest në burg”, duhet të lexohet në përputhje me detyrimin e gjykatës për shqyrtimin real të masave më pak kufizuese, me kërkesën për arsyetim konkret, të individualizuar dhe të kontrollueshëm, mbi rrezikshmërinë e veprës dhe të personit, si dhe me barrën e organit të akuzës për të justifikuar nevojën e kufizimit më të rëndë të lirisë personale.

IV. Për zgjidhjen e çështjes konkrete

67. Kolegjet e Bashkuara në lidhje me të drejtën e rekursit në lëndë të masave të sigurimit vënë në dukje se neni 249, pika 8 i KPP parashikon pikërisht të drejtën e ankimit për masat e sigurimit kundër vendimit të Gjykatës së Apelit. Konkretisht, neni 249, pika 8 i KPP: “(...) 8. Kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet recurs për shkelje të ligjit në Gjykatën e Lartë, brenda kompetencës së saj.” Sipas qëndrimit të konsoliduar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe në interpretim të kësaj dispozite ligjore, termi i aplikuar në këtë dispozitë “për shkelje të ligjit”, qartazi i referohet parashikimeve të shprehura në nenin 432/1, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të po këtij Kodi. Neni 432, pika 1 i KPP parashikon se rekursi kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet: a) për mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; b) për mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; c) kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kolegjet e Bashkuara ritheksojnë se edhe në rastin e rekursit në lidhje me caktimin e një mase sigurimi, rekursuesi duhet të argumentojë shkeljen e ligjit referuar shkaqeve të cituara më lart, brenda kompetencës së Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji, pa e shndërruar rekursin në një mjet për rivlerësimin e lirë të provave ose të rrethanave faktike (*shih vendimin nr. 1633, datë 04.11.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

68. Në lidhje me çështjen konkrete, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se pretendimet e rekursit nuk gjejnë mbështetje në ligj dhe në kufijtë e kontrollit kasacional që ushtron Gjykata e Lartë. Argumentet e rekursit, të mbështetura kryesisht në natyrën e veprës penale, sasinë e lëndës narkotike, marzhin e dënimit dhe rrezikun e përgjithshëm të largimit ose përsëritjes së veprës, nuk mjaftojnë për të justifikuar automatikisht caktimin e masës “arrest në burg”, në mungesë të një analize konkrete që të tregojë papërshtatshmërinë e masave më pak kufizuese. Edhe pretendimi se vendimi i gjykatës së apelit është i mangët për shkak se nuk ka arsyetuar hollësisht mënyrën e ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së masës “arrest në shtëpi” nuk përbën shkak për prishjen e vendimit, pasi përmbajtja, zbatimi dhe kontrolli i kësaj mase parashikohen nga neni 237 i KPP dhe nga kuadri ligjor për ekzekutimin e vendimeve penale.

69. Nga shqyrtimi i vendimit të gjykatës së apelit, në kufijtë e rekursit dhe të kontrollit të ligjshmërisë, rezulton se kjo e fundit ka zbatuar në mënyrë korrekte kuadrin ligjor përkatës si dhe standardet kushtetuese dhe konventore për mbrojtjen e lirisë personale. Gjykata e apelit ka konstatuar ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova për kryerjen e veprës penale dhe, më tej, ka kaluar në vlerësimin e llojit të masës së sigurimit, duke analizuar në mënyrë konkrete kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenet 228-229 dhe në përputhje me nenin 245, pika 1, të KPP. Ajo ka kryer një analizë të individualizuar të rrethanave të rastit dhe të elementeve personale të të hetuarit Begtash Zeneli, duke marrë në konsideratë moshën e tij 63-vjeçare, statusin si kryefamiljar, gjendjen shëndetësore të bashkëshortes, si dhe faktin se rezulton i rehabilituar nga dënimi i mëparshëm. Ky vlerësim pasqyron kalimin analitik nga rëndësia abstrakte e veprës penale tek personi konkret, në përputhje me parimin se rrezikshmëria nuk mund të nxirret automatikisht vetëm nga natyra e veprës, marzhi i dënimit ose rëndësia e saj e përgjithshme shoqërore, por kërkon një analizë të plotë dhe të individualizuar të rrethanave konkrete të faktit dhe të autorit. Në këtë kuptim, gjykata e apelit ka arsyetuar se, ndonëse vepra penale e prodhimit dhe shitjes së narkotikëve paraqet rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe përbën prioritet për drejtësinë penale, këto

elemente nuk mjaftojnë në vetvete për të justifikuar aplikimin e masës më të rëndë të sigurimit personal. Ajo ka vlerësuar se nuk rezultojnë rrethana të veçanta që të tregojnë rrezikshmëri të shtuar, as të veprës dhe as të autorit, në atë shkallë që ta bëjnë “arrestin në burg” të domosdoshëm si masën e vetme të përshtatshme, ndërsa masa e “arrestit në shtëpi”, e parashikuar nga neni 237 i KPP, përmbush në mënyrë proporcionale nevojat e sigurimit në rastin konkret. Ky arsyetim reflekton standardin e individualizimit të masës së sigurimit dhe natyrën “ultima ratio” të arrestit në burg.

70. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se edhe pretendimi i ngritur në rekurs lidhur me ekzistencën e rrezikut të largimit, nuk mbështetet dhe argumentohet në elemente konkrete dhe të individualizuara, por kryesisht në konsiderata abstrakte si rëndësia e veprës penale, marzhi i dënimit, precedentët penalë të mëparshëm dhe pretendimi se anëtarë të familjes së të dyshuarit janë të përfshirë në aktivitete të kundërligjshme. Sikurse është arsyetuar më sipër, rëndësia e veprës penale dhe marzhi i dënimit janë elemente relevante, por jo të mjaftueshme në vetvete për të justifikuar caktimin e masës së arrestit në burg. Një masë e tillë kërkon një vlerësim konkret, të individualizuar dhe të arsyetuar, të bërë në mënyrë kumulative si për rrezikshmërinë e veprës, ashtu edhe për rrezikshmërinë e personit konkret ndaj të cilit caktohet masa. Në këtë drejtim, gjykata e apelit ka vlerësuar drejt faktin e rehabilitimit të të dyshuarit dhe mungesën e elementeve konkrete që të tregojnë rrezik real për shmangie nga drejtësia, pengim të hetimit ose përsëritje të veprës penale në kushtet e zbatimit të masës së “arrestit në shtëpi”. Sa i përket precedentëve penalë, gjykata e apelit ka konstatuar se personi rezultoi i rehabilituar, element ky që duhet të vlerësohet si rrethanë individuale në favor të tij. Ndërsa pretendimi lidhur me përfshirjen e anëtarëve të familjes në aktivitete të kundërligjshme, edhe nëse mund të ketë rëndësi për kontekstin e çështjes, nuk mund të shërbejë si bazë për t’i atribuar personit nën hetim një rrezikshmëri shtesë mbi bazën e sjelljes së personave të tjerë, pasi vlerësimi i rrezikshmërisë duhet të jetë individual dhe i mbështetur në elemente personale të personit ndaj të cilit caktohet masa e sigurimit.

71. Sa i përket pretendimit të ngritur në rekurs se gjykata e apelit ka vepruar në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 7/2011, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se ky pretendim duhet parë nën dritën e saktësisimit, qartësisimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të praktikës gjyqësore të njëzuar. Formulime të caktuara të atij vendimi, që lidhen me nxjerrjen e rrezikshmërisë kryesisht nga natyra abstrakte e veprës penale dhe me mungesën e një detyrimi për analizimin efektiv të masave alternative, rezultuan se nuk janë më plotësisht në përputhje me kuadrin aktual ligjor dhe me standardet kushtetuese e konventore të mbrojtjes së lirisë personale. Në këtë kontekst, arsyetimi i gjykatës së apelit rezultoi në përputhje me standardet e përcaktuara në këtë vendim për qartësimin, saktësimin, standardizimin, ndryshimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të disa formulimeve të pjesës arsyetuese të vendimit unifikues nr. 7 të vitit 2011.

72. Prokuroria e Përgjithshme, ndryshe nga Prokuroria e Apelit, pretendoi në seancë gjyqësore se vendimi i gjykatës së apelit është i bazuar përsa i përket llojit të masës së sigurimit të caktuar ndaj personit nën hetim Begtash Zeneli, por sipas saj ai paraqitet i mangët në arsyetim, pasi nuk shpjegon hollësisht mënyrën e zbatimit dhe të mbikëqyrjes së masës së “arrestit në shtëpi”, si dhe sesi kjo masë garanton paraqitjen e të pandehurit në procesin penal. Sipas Prokurorisë së Përgjithshme, një arsyetim i tillë bie ndesh me standardet e GJEDNJ dhe me kërkesat e KPP, duke e bërë masën jo efektive dhe vendimin të cenueshëm. Për këtë arsye, Prokuroria e Përgjithshme kërkoi prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

73. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se ky pretendim nuk qëndron. Mungesa e një arsyetimi të detajuar nga gjykata e apelit mbi mënyrën konkrete të ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së masës

“Arrest në shtëpi” nuk përbën, në rastin konkret, shkak për prishjen e vendimit, për sa kohë gjykata ka përcaktuar vendin e qëndrimit dhe ndalimin e largimit, ndërsa zbatimi dhe kontrolli i mëtejshëm i masës garantohen nga kuadri ligjor përkatës. Konkretisht, neni 237 i KPP parashikon se: *“1. Me vendimin e arrestit në shtëpi, gjykata urdhëron të pandehurin të mos largohet nga banesa e tij ose nga një vend i caktuar ku ai banon, kurohet ose mbahet me asistencë. 2. Kur cakton këtë masë, gjykata përcakton edhe mënyrën e ekzekutimit dhe të mbikëqyrjes së saj. 3. Prokurori dhe policia gjyqësore kontrollojnë respektimin e urdhrave që i janë dhënë të pandehurit. 4. Për kohëzgjatjen e arrestit në shtëpi vlejné rregullat e caktuara për paraburgimin. 5. Koha e qëndrimit në arrest në shtëpi llogaritet në caktimin e dënimit.”* Kjo dispozitë përcakton elementet thelbësore të masës së arrestit në shtëpi, mënyrën e ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së saj, si dhe rolin e prokurorit dhe të policisë gjyqësore në kontrollin e respektimit të urdhrave të vendosur nga gjykata. Po kështu, ligji nr. 79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” ngarkon prokurorin me detyrimin për të marrë masat e nevojshme për ekzekutimin e vendimit penal dhe për të kontrolluar rregullsinë e zbatimit të tij, duke parashikuar edhe mekanizmat për ndërhyrje në rast parregullsish. Për rrjedhojë, edhe në mungesë të një detajimi të hollësishëm në arsyetimin e vendimit, kuadri ligjor ekzistues garanton mekanizmat e nevojshëm për ekzekutimin dhe mbikëqyrjen efektive të masës së “arrestit në shtëpi”. Kolegjet e Bashkuara konstatojné se gjykata e apelit, në dispozitivin e vendimit, ka përcaktuar detyrimin e personit nën hetim Begtash Zeneli për të qëndruar në banesën e tij sipas adresës së specifikuar, si dhe ka parashikuar kontrollin e zbatimit të kësaj mase nga prokuroria dhe policia gjyqësore. Në këto kushte, edhe në mungesë të një arsyetimi më të detajuar mbi mënyrën konkrete të mbikëqyrjes, për sa kohë dispozitivi është i qartë dhe i ekzekutueshëm, kuadri ligjor ekzistues garanton mekanizmat e nevojshëm për ekzekutimin dhe kontrollin efektiv të masës së “arrestit në shtëpi”, çka e bën të pabazuar kërkesën për prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

74. Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara, në zbatim të nenit 441, pika 1, shkronja “e” të KPP, vlerësojnë se vendimi nr. 30-2025-9596 (2998), datë 17.11.2025, i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të neneve 438 dhe 441, pika 1, shkronja “e” të Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S Ë N:

Lënie në fuqi të vendimit nr. 30-2025-9596 (2998), datë 17.11.2025, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Ky vendim dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë më 04.05.2026